



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

RAPORTI VJETOR

2007

Prishtinë
Mars, 2008

ZYRA E RREGULLATORIT PER ENERGJI

Rruga "Hamdi Mramori" nr.1

1000 Prishtine, Kosove

tel: +381 (0) 38 247 615 lok 101

Faks: +381 (0) 38 247 620

E-mail: ero-ks.org



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

RAPORTI VJETOR 2007

**Prishtinë
Mars, 2008**

Në këtë Raport vjetor për vitin 2007 janë dhënë në formë të përmbledhur punët dhe aktivitetet kryesore të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), të Bordit Drejtues dhe të shërbimeve teknike të saj. Më tej, janë prezantuar observimet, të dhënat dhe rezultatet të bazuara në një analizë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve në sektorin e energjisë në Kosovë, sidomos ato të zhvillimit të tregut dhe të shërbimeve publike në këtë sektor. Këtu janë përfshirë edhe raportet financiare bazë lidhur me realizimin e buxhetit të Zyrës për vitin 2007. Në raport janë dhënë edhe të dhënat tekniko-ekonomike për aktivitetet e rregulluara të sektorit .

ZRRE-ja e themeluar në vitin 2004 në pajtim me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë luan një rol të rëndësishëm në transformimin e sektorit të energjisë, në operimin e tregut të rregulluar dhe konkurrues, në rregullimin e ndërmarrjeve energjetike që kanë pozitë monopoli, në dhënien e licencave operuese për pjesëmarrësit në treg dhe në mbikëqyrjen e tregut dhe të të licencuarve.

ZRRE financohet nga të ardhurat vetanake, nga taksat që i mbledh nga të licencuarit. Buxheti i ZRRE-së është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Gjatë këtij viti, përkundër të hyrave të mjaftueshme, ZRRE-së i është lejuar një buxhet i kufizuar për financimin e veprimtarisë së saj, veçanërisht janë shkurtuar mjetet e destinuara për kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Ky shkurtim ka shkaktuar probleme të mëdha me largimin e një numri të madh të stafit profesional nga ZRRE-ja dhe vështirësi për të rekrutuar staf të ri me përvojë e aftësi të veçantë nga lëmi i rregullimit.

Gjatë vitit 2007 ZRRE ka kryer me sukses punët dhe përgjegjësitë e caktuara me ligjet bazë që rregullojnë aktivitetet e veçanta në lëmin e energjisë, si dhe me ligjet dytësore të nxjerra në bazë të këtyre ligjeve. Është hartuar e aprovuar shumica e legjislacionit dytësor që parashihet me ligjet relevante, duke siguruar një bazë të mirë ligjore për hapjen e tregut të energjisë. Janë shpallur kushtet e reja për marrjen e statusit të konsumatorit të kualifikuar, duke krijuar kështu premisa për hapjen e mëtutjeshme të tregut të energjisë.

ZRRE i ka kushtuar rëndësi të veçantë bashkëpunimit me ministritë relevante të qeverisë së Kosovës, me komisionet parlamentare të Kuvendit të Kosovës dhe me UNMIK-un, për t'i bashkërenditur aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e strategjisë dhe të politikave në sektorin e energjisë. Është punuar në hartimin e projekt-rregulloreve për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë dhe në ato për vendosjen e një kornize ligjore adekuate për përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe për bashkëgjenerim.

Ndihmesë të vlefshme teknike për realizimin e këtij qëllimi si dhe për rritjen e kapaciteteve të stafit kanë dhënë donatorët AER, USAID dhe Banka Botërore.

ZRRE ka vazhduar bashkëpunimin me institucione e organizata ndërkombëtare në lëmin e rregullimit siç janë: Këshilli i Rregullatorëve të Energjisë i Evropës (CEER) dhe Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë (ERRE). ZRRE ka marrë pjesë aktive në procesin e themelimit të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB), si dhe të grupeve punuese në kuadër të tij, në pajtim me Traktatin e Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore (KEJL).

Gjatë këtij viti ka vazhduar licencimi i aktiviteteve në sektorin e energjisë, sidomos për furnizim/tregti me energji elektrike. Një aktivitet tjetër i rëndësishëm i Zyrës ka qenë monitorimi i të licencuarve për të konstatuar nëse aktivitetet e licencuara kryhen në përputhshmëri me kushtet e licencave të lëshuara e me qëllim të përmirësimit të nivelit të shërbimit e të furnizimit të sigurt të konsumatorëve.

Për herë të parë është bërë rishikimi i çmimeve dhe vendosja e tarifave të reja të energjisë elektrike të bazuara në Metodologjinë e tarifave. Këto tarifa janë të shthurura dhe bazohen në koston e prodhimit e të shërbimit; në eliminimin gradual të ndërsuaveve në mes të kategorive të konsumatorëve dhe në përballueshmërinë e tyre nga konsumatorët.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar fushës së mbrojtjes së konsumatorëve përmes monitorimit të ndërmarrjeve energjetike, duke shqyrtuar ankesat e kontestet e veçanta të konsumatorëve lidhur me kushtet dhe cilësinë e shërbimeve të furnizimit me energji (matja, faturimi, shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë etj.)

Në vazhdimësi, ZRRE i shpall vendimet që janë të rëndësishme për publikun përmes mediave elektronike dhe të shkruara. Veprimtaritë, deklaratat, risitë si dhe ngjarjet më të rëndësishme përkritazi me tregun e energjisë mbahen të përditësuara në faqen e internetit të ZRRE-së.

Me respekt,



Dr. Ali Hamiti

Kryesues i Bordit

HYRJE	i
LISTA E SHKURTESAVE	ii
KREU 1: NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR ZYRËN E	
RREGULLATORIT TË ENERGJISË SË KOSOVËS	1
1.1 Baza ligjore, mandati i ZRRE-së	1
1.2 Organizimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji	
dhe burimet njerëzore	1
1.3 Plani i Biznesit	5
1.4. Raporti vjetor financiar i ZRRE-së	6
KREU 2: ZHVILLIMET RREGULLATIVE	9
2.1 Aktivitetet rreth zhvillimit dhe aprovimit të legjislacionit dytësor	9
2.2 Aktivitetet rreth licencimit dhe monitorimit të	
operatorëve të licencuar	10
2.3 Informimi i publikut	11
2.4 Vendimet e marra nga Bordi i ZRRE-së	11
KREU 3: ZHVILLIMET NË SEKTORIN E ENERGJISË	12
3.1 Aktivitete në sektor të energjisë elektrike	12
3.2 Tregu i energjisë elektrike	13
3.3 Prodhimi dhe shpenzimi i energjisë elektrike	15
3.4 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike	18
3.5. Humbjet ne sistemin elektro-energetik të Kosovës	21
3. 6 Aktivitetet për vendosjen e tarifave për energji elektrike	22
3.7 Sektori i gazit	30

3.8 Sektor i ngrohjes qendrore	32
3.9 Zhvillimi i mëtutjeshëm i Projektit Kosova-C	39
KREU 4: MBROJTJA E KONSUMATORËVE	42
4.1 Baza ligjore dhe rregullative	42
4.2 Ankesat dhe aktivitetet e ZRRE-së në zgjidhjen e	43
KREU 5: BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	49
5.1 Bashkëpunimi me institucione dhe organizata vendore si dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme	49
5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe pjesëmarrja në takime të organizuara në kuadër të Traktatit të Energjisë së Evropës Juglindore	49

LISTA E SHKURTESAVE

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AER-i	Agjencia Evropiane për Rindërtim
EAR	European Agency for Reconstruction
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BRR	Baza Rregullative për Asete (RAB-Regulatory Asset Base)
DÇLL	Departamenti për Çështje Ligjore dhe Licencim
DMK	Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve
ERRA	Energy Regulators Regional Association
EFT	Energy Financing Team (Ekipi për Financimin e Energjisë)
EGL	Elektrizitats Gesellschaft Laufenburg
ETSO	Operator i Transmisionit Europian (European Transmission System Operator)
EMS	Rrjeti Elektrik i Serbisë (Elektro Mreza Serbije)
ERGEG	Grupi i Rregullatorëve Evropian për Energji Elektrike dhe Gaz
GWh	Giga Watt orë
HC	Hydrocentral
HSE	Holding Slovenske Elektrane
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESH	Korporata Energjetike e Shqipërisë
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit (Bartjes) dhe Tregut në Kosovë
KOSTT	Kosova Operator System for Transmission and Trade
KQKO	Komisioni Qeverisës i Kodeve Operacionale
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
KNQ	Kompani për Ngrohje Qendrore
KW	Kilovat
KWh	Kilovat orë
KEEJL	Komuniteti i Energjisë në Evropën Juglindore
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MW	Megavat
MWh	Megavat orë
WACC	MPKK - Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (Weighted Average Cost of Capital)
NARUC	Asociacioni Nacional i Komisionerëve të Ndërmarrjeve Rregullative (National Association of Regulatory Utility Commissioners)
NERA	Kompani ndërkombëtare ekonomike konsulente (NERA Economic Consulting)
NQ	Ngrohje Qendrore
NjNQ	Njësia e Ngrohjes Qendrore
NA	Nuk Aplikohet
NPK	Ndërmarrje Publike Komunale

NP	Ndërmarrje Publike
NeK	Norma e Kthimit
OPSTT	Operator i Pavarur i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut
OS	Operator Sistemi
OST	Operatori i Sistemit të Transmisionit
OT	Operator Tregu
ORRSh	Operator i Rrjetit të Shpërndarjes (Distibucion-it)
OSSH	Operator i Sistemit të Shpërndarjes
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SRO	Kompania e licencuar për tregtim/furnizim me energji elektrike
EZPADA	Kompani e Republikës Çeke
SFTE	Struktura e Furnizimit dhe Tregut të Energjisë
ShKKRRK	Shoqata Kombëtare e Komisionarëve Rregullativ për Komunalitë
SH.A.	Shoqëri Aksionare
SHST	Shfrytëzimi i Sistemit për Transmision
TKEEJL	Traktati i Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore
(ECTSEE	Energy Community Traty of South East Europe)
TC	Termocentral
TNK	Tregtim Ndërkufitar
UE	Unioni European
UCTE	Unioni për Koordinimin e Transmisionit të Energjisë Elektrike (Union for the Co-ordination of Transmission of Electricity)
UNMIK	Misioni të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (United Nations Interim Administration Mission in Kosovo)
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (United States Agency for International Development)
ZÇF	Zyra për Çështje Fiskale
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR ZYRËN E RREGULLATORIT PËR ENERGJI TË KOSOVËS

1.1 BAZA LIGJORE DHE MANDATI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë nr. 2004/9, Zyra e Rregullatorit për Energji është themeluar si autoritet i pavarur, që ushtron rregullimin ekonomik në sektorin e energjisë elektrike, ngrohjes qendrore dhe gazit natyror.

Përgjegjësitë e Zyrës së Rregullatorit për Energji janë të përcaktuara në nenin 15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe ushtrohen përmes: lëshimit dhe monitorimit të licencave për aktivitetet e energjisë, dhënies së lejeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, të rrjeteve të gazit, të linjave direkte elektro-energetike dhe të linjave gypore direkte, të aprovimit të metodologjisë së çmimeve dhe tarifave për aktivitetet që nuk i nënshtrohen tregut, të nxjerrjes së legjislacionit dytësor që rregullon sektorin e energjisë, të monitorimit të ndarjes efektive dhe zhvillimit të konkurrencës në sektorin e energjisë, dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë.

1.2 ORGANIZIMI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI DHE BURIMET NJERËZORE

■ Bordi i zyrës së rregullatorit për energji

ZRRE-ja është e organizuar në pajtim me Kreun 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Ajo drejtohet nga pesë anëtarë të Bordit. Në mandatin e parë dy anëtarë të Bordit janë zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa tre anëtarët tjerë duke përfshirë edhe Kryesuesin e Bordit janë zgjedhur nga PSSP-ja. Në fillim të vitit 2007 kryetari i bordit është zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës.

Anëtarët e Bordit përmbushin detyrat dhe obligimet në përputhje me përgjegjësitë që parashihen me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë.

■ Departamentet e zyrës së rregullatorit për energji

Departamenti Ligjor dhe i Licencimit

Departamenti ligjor dhe i licencimit (DLL) i siguron ZRRE-së mbështetje ligjore sipas ligjeve në fuqi në Kosovë, për të gjitha çështjet në sektor të energjisë. DLL gjatë përgatitjes së legjislacionit dytësor dhe akteve tjera nënligjore përveç që bazohet në ligjet e Kosovës si pikë reference i ka edhe Direktivat dhe Rregulloret e Unionit

European. DLL gjithashtu përgatit të gjitha llojet e licencave, aplikacioneve, procedurat dhe autorizimet për themelimin dhe operimin e të gjitha aktiviteteve në sektor të energjisë. Pas licencimit të aktiviteteve të energjisë nga ZRRE-ja, DLL bënë mbikëqyrjen dhe monitorimin e këtyre aktiviteteve, në pajtueshmëri me kushtet e dhëna në licencën përkatëse dhe vendimet përkatëse të ZRRE-së.

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve (DMK) merret me ankesat e konsumatorëve dhe me kontestet ndërmjet organizatave energjetike. Departamenti gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi bashkëpunon me të gjitha organizatat të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët.

Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve

Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve (DÇT) merret me tarifat në përgjithësi. Ai analizon sistemet tarifore të propozuara nga organizatat energjetike, strukturat dhe nivelet tarifore. Krijon sistemin e monitorimit të kostos. Përpilon studime mbi kostot dhe çmimet që janë të krahasueshme me kompanitë tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Është përgjegjës për modelimin dhe analizimin e tregut të energjisë, duke e mbështetur aktivitetin rregullativ. Gjithashtu bën modelimin e tregjeve të ndryshme, analizon sjelljen e pjesëmarrësve të tregut, propozon amendamentet e rregullave të tregut duke krijuar konkurrencë efikase. Është përgjegjës për implementimin e elementeve të reja të konkurrencës në treg.

Departamenti i Furnizimit me Energji dhe Strukturë të Tregut

Departamenti i Furnizimit me Energji dhe Strukturë të Tregut (DFEST) mbledh dhe analizon informatat lidhur me kapacitetin dhe bilancin e energjisë. Analizon ndikimin e faktorëve të ndryshëm si: inflacionin, çmimin e lëndës djegëse, zhvlerësimin etj., në çmimin e tregut dhe në çmimin e rregulluar të konsumatorit fundor. Ky departament bën edhe monitorimin e çmimeve të tregut.

Grupi teknik këshillëdhënës

Grupi teknik këshillëdhënës i ofron këshilla teknike Bordit të ZRRE-së dhe departamenteve, për t'i përmbushur funksionet e tyre për themelimin e një tregu konkurrent të energjisë në pajtueshmëri me ligjin. Ndihmon në përpilimin e tekstit të licencave për ndërmarrjet energjetike me qëllim të përmbushjes së aktiviteteve të tyre siç janë: gjenerimi, transmissioni, shpërndarja dhe furnizimi. Shqyrton dhe komenton Dizajnin e Tregut dhe Rregullat e Tregut.

Zyra administrative

Zyra administrative mbështet udhëheqjen e ZRRE-së për një funksionim normal të departamenteve. Organizon rekrutimin efikas të stafit të ZRRE-së. Koordinon trajnimet e stafit të ZRRE-së. Koordinon furnizimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës.

Ndihmon në rregullimin e zyrës duke e bërë atë të përshtatshme për punë për të gjithë stafin e ZRRE-së.

■ Stafi i zyrës së rregullatorit për energji

ZRRE-ja në fillim të vitit 2007 ka pasur 21 anëtarë stafi. Gjatë kësaj periudhë ZRRE-ja është përballur me largim të stafit, kryesisht atij profesional, për shkak të zvogëlimit të buxhetit dhe linjës buxhetore për paga. Kjo ka rezultuar në zvogëlimin e numrit të anëtarëve të stafit në 15 anëtarë. Gjashtë anëtarë të stafit profesional, duke përfshirë edhe një anëtarë të Bordit, të gjithë të trajnuar brenda një periudhe dy vjeçare dhe të pajisur me shkathtësi specifike, kanë dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre. Kjo lëvizje e stafit të ZRRE-së ka shkaktuar vështirësi të mëdha në përmbushjen e obligimeve të saja.

Me kërkesë të ZRRE-së, Kuvendi i Kosovës lejoi një ndryshim në linjat buxhetore të buxhetit të ZRRE-së për vitin 2007. Kjo mundësoi që ZRRE-ja në pjesën e dytë të vitit 2007 t'i rekrutojë dhe t'i plotësojë disa nga vendet e zbrazëta të punës. Me gjithë këto vështirësi, ZRRE-ja gjatë vitit 2007 ka arritur të jetë funksionale dhe efikase në kryerjen e aktiviteteve të saja. Për zbatimin e procedurave financiare, të gjithë udhëheqësit e autorizuar kanë qenë vendor, duke përfshirë edhe zyrtarin autorizues.

■ Skema organizative e zyrës së rregullatorit për energji




Fig. 2.1 Skema organizative e Zyrës së Rregullatorit për Energji

■ Trajnimet dhe asistenca teknike

Gjatë vitit 2007 ka vazhduar projekti i asistencës teknike “Sigurimi i ndihmës për ngritje të kapaciteteve të ZRRE-së”, i financuar nga AER dhe i implementuar nga kompania konsulente ndërkombëtare “NERA Economic Consulting”. Qëllimi kryesor i projektit është që në mënyrë efikase të implementojë kornizën rregullative dhe të sigurojë kushte transparente dhe jo-diskriminuese të funksionimit të tregut të energjisë në Kosovë, në pajtueshmëri të plotë me ligjet e energjisë në Kosovë dhe me kërkesat që dalin nga zbatimi i Traktatit të Komunitetit të Energjisë në Evropën Juglindore, nënshkrues i të cilit është edhe Kosova.

Projekti e ka fuqizuar ZRRE-në në shume fusha që kanë rëndësi esenciale për operim dhe monitorim të tregut:

- o shqyrtimi dhe miratimi i kodeve të ndryshme teknike dhe operacionale;
- o implementimi i shqyrtimit të çmimeve për aktivitetet e ndryshme të energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore, bazuar në metodologjinë e tarifave;
- o dizajni, analiza dhe vlerësimi i kërkesave licencuese, duke pasur parasysh kërkesat për lëshim të licencave
- o dizajni dhe përgatitja e specifikimeve për sistemet e teknologjisë Informative, të nevojshme për punën e ZRRE-së;
- o njohja me procedurat për menaxhim kualitativ të punës në ZRRE ;
- o trajnimi i duhur i stafit të ZRRE-së në fushat e lartpërmendura.

Në kuadër të këtij projekti një pjesë e stafit të ZRRE-së ka bërë një vizitë studimore në “E-Control” Agjensionin Rregullativ për Energji Elektrike dhe Gaz, Vjenë, Austri.

- Në shkurt 2007 dy anëtarë të stafit, njëri nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve dhe tjetri nga Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve kanë ndjekur kursin nga distanca “Rregullimi i Çmimeve dhe Tarifave”, të organizuar nga “ARRE” (ERRA), Qëllimi kryesor i kursit ishte që t’i mësojë pjesëmarrësit me konceptet kryesore, objektivat dhe teknikat e dizajnit dhe vlerësimit të strukturës tarifore në sektorin e energjisë.

- Në mars të 2007 dy anëtarë të stafit nga Departamenti Ligjor dhe i Licencimit kanë marrë pjesë në konferencën “Standardet Evropiane Hulumtuese për Energji Elektrike E-TRACK” të organizuar në Bruksel dhe të implementuar nga Agjensioni Flaman për Energji, nga Belgjika. Temat e diskutuara në këtë konferencë kishin të bënin me energjinë e gjelbërt.

- Në qershor 2007 anëtarët e stafit profesional të ZRRE-së kanë marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga “Qendra për Zhvillimin e Sektorit të Energjisë dhe Burimeve Natyrore” të Universitetit Amerikan të Kosovës, me temën “Ristrukturimi i Energjisë Elektrike në SHBA: Mësime për Evropën Juglindore”. Kjo punëtori është mbajtur në Universitetin Amerikan të Kosovës.

- Në korrik të 2007, një anëtar stafi nga Departamenti Ligjor dhe i Licencimit ka marrë pjesë në shkollën verore e cila është organizuar nga ARRE (ERRA), në Budapest, Hungari. Qëllimi kryesor i kursit ishte që të sigurojë aftësitë bazike rregullative, teknike, ekonomike dhe ligjore që janë të nevojshme për të menaxhuar sistemet e suksesshme rregullative për industrinë e energjisë elektrike.
- Në korrik 2007, Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së, ka ndjekur kursin trajnues për komisionerë të organizuar nga (NARUC/ERRA) në Budapest, Hungari.
- Në korrik 2007 një anëtar stafi nga Departamenti Ligjor dhe i Licencimit ka marrë pjesë në shkollën verore, e cila është organizuar nga ARRE (ERRA), në Budapest, Hungari. Qëllimi kryesor i kursit ishte që t'i japë njohuri themelore rregullative, ekonomike dhe ligjore.
- Duke filluar nga shtatori 2007, katër anëtarë të stafit udhëheqës të ZRRE-së kanë filluar të vijnë kursin "Programi për Zhvillim Profesional" të financuar nga "USAID" dhe të implementuar nga kompania konsulente "BEARING POINT" nga SHBA.
- Në nëntor 2007, dy anëtarë të stafit të ZRRE-së, njëri nga Departamenti për Furnizim me Energji dhe Strukturë të Tregut dhe tjetri nga Departamenti për Tarifa dhe Çmime kanë marrë pjesë në trajnimin "Energjia dhe rregullimi", të organizuar dhe mbështetur nga Qeveria e Sllovenisë dhe Britanisë së Madhe në bashkëpunim me "Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë së Europës Juglindore". Trajnimi është mbajtur në Jable të Sllovenisë.

1.3 PLANI I BIZNESIT

Ky dokument definon orientimet strategjike të ZRRE-së për periudhën 2005-2009 dhe në përgjithësi në të jepet: misioni, mandati, qëllimet dhe organizimi i ZRRE-së; siguron një pasqyrë të strukturës dhe perspektivave zhvillimore në sektorin e energjisë në Kosovë; identifikon sfidat me të cilat ZRRE-ja ballafaqohet në lidhje me qëllimet dhe faktorët strategjik që do të ndikonin në tejkalimin e këtyre sfidave; specifikon projektet dhe cakton strategjitë dhe iniciativat për këtë periudhë financiare; definon resurset e kërkuara për implementimin e projekteve dhe iniciativave të planifikuara; përmban parashikime të detajuara financiare për periudhën e planifikuar pesë vjeçare.

Më saktësisht për vitin 2007 ky plan ka paraparë:

- Bashkëpunimin me palët e interesuara në sektorin e energjisë lidhur me implementimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore;
- Monitorimin e bizneseve të të gjitha kompanive energjetike;
- Monitorimin e tregut të energjisë si dhe zhvillimin e tij;
- Pjesëmarrjen në shqyrtimin e çmimeve të kompanive energjetike dhe sigurimin që ato të përputhen me metodologjinë e tarifave, që është miratuar nga ZRRE-ja në sektorin e rregulluar, dhe që këto çmime nuk pasqyrojnë keqpërdorim në sektorin e pa-rregulluar;

- Mbledhja e të dhënave nga kompanitë energjetike, kompletimi dhe publikimi i tyre;
- Zhvillimin e fushatës për ngritje të vetëdijes lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve;
- Sigurimin që asnjë kompani energjetike të mos e keqpërdorë pozitën e vet dominante dhe të ndalohen praktikant anti-konkurruese;
- Mbrojtjen e konsumatorëve dhe kompanive energjetike në mbështetje me procedurat për zgjidhje të kontesteve;
- Krijimin e kushteve të favorshme për investime të reja dhe hapja e tregut për kompanitë e reja të ngrohjes;

1.4 RAPORTI FINANCIAR VJETOR I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI - VITI 2007

Zyra e Rregullatorit për Energji financohet nga të hyrat vetanake, në pajtim me ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Kreu 4, përkatësisht nga taksat që mbledhen nga operatorët e licencuar. Nga taksat e planifikuara të të licencuarve, për vitin 2007, ZRRE-ja ka arkëtuar 944,104 €, ndërsa pjesa prej 351,979 €, e faturuar në vitin 2007, mbetet të arkëtohet në vitin 2008. Në pajtim me Nenin 20.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, mjete e pashpenzuara duhet të barten në buxhetin e ZRRE-së për vitin e ardhshëm fiskal.

Kuvendi i Kosovës me vendimin Nr. 02-2844-1/06 të datës 23.12.2006, miratoi buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji në shumë prej 537,623.00 €.

Buxheti i aprovuar ka qenë i shpërndarë në katër kategori kryesore:

1. Paga dhe mëditje	198,123.00 €
2. Mallra dhe shërbime	296,000.00 €
3. Shpenzime komunale	21,500.00 €
4. Shpenzime kapitale	22,000.00 €

Gjatë periudhës së rishqyrtimeve buxhetore Zyra e Rregullatorit për Energji ka kërkuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës lejimin e bartjes së mjeteve në shumën prej 45,000.00 € nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Kjo kërkesë është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me vendimin Nr. 02- 3615-1/07, datë 27 gusht 2007.

Bazuar në këtë vendim shuma e pjesëmarrjes së mjeteve buxhetore në kategoritë kryesore kanë këtë përbërje:

1. Paga dhe mëditje	243,123.00 €
2. Mallra dhe shërbime	251,000.00 €
3. Shpenzime komunale	21,500.00 €
4. Shpenzime kapitale	22,000.00 €

Në tabelat e mëposhtme janë të paraqitura detajisht të dhënat financiare:

Tab. 1.1 Pasqyra e burimeve të mjeteve dhe e shpenzimeve.

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI	VITI 2007	
	Buxheti	Aktual
BURIMET E FONDEVE		
Të hyrat e bartura nga viti 2006	134,597	134,597
Të hyrat e mbledhura në vitin 2007	1,102,582	944,104
GJITHSEJ BURIMET E FONDEVE	1,237,179	1,078,701
SHFRYTËZIMI I FONDEVE		
Shpenzimet e Stafit	243,123	186,799
Mallra dhe Shërbime	251,000	170,846
Shpenzimet komunale	21,500	8,481
Shpenzimet kapitale	22,000	21,261
GJITHSEJ SHFRYTEZIMI I FONDEVE	537,623	387,387

Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve si dhe mallrave dhe shërbimeve të përmbledhura në nën kategoritë kryesore:

Tab. 1.2 Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve, mallërave dhe shërbimeve

PAGAT DHE MËDITJET	SHUMA
Pagat neto	146,777
Tatimi I ndalur në të ardhura personale	8,895
Kontributi pensional I punëdhënsit	8,895
Kontributi pensional I të punësuarit	22,232
Gjithsej pagat dhe mëditjet	186,799

MALLRAT DHE SHËRBIMET	SHUMA
Shpenzimet e udhëtimit	11,313
Shpenzimet e internetit	1,040
Shpenzime tjera telefoni	8,343
Shpenzime postare	2,931
Shpenzimet për shërbime	7,076
Mobiljet dhe pajisjet	9,659
Shpenzimet tjera	36,857
Derivate dhe lëndë djegëse	8,393
Mirëmbajtja	16,031
Qiraja	49,560
Shpenzimet e marketingut	12,374
Shpenzimet për dreka, darka / reprezentacionit	458
Shpenzimet e ushqimit për udhëtime zyrtare	6,811
Gjithsej shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve	170,846

Tab. 1.3 Shpenzimet totale të ZRRE-së për vitin 2007 të shprehura në përqindje

Emërtimi i ndarjeve buxhetore	Shuma e aprovuar	Shuma e shpenzuar	Përqindja e shpenzimeve të realizuara për kategori
Shpenzimet e stafit	243,123	186,799	76.83%
Mallrat dhe Shërbimet	251,000	170,846	68.07%
Shpenzimet komunale	21,500	8,481	39.45%
Shpenzimet kapitale	22,000	21,261	96.64%
Totali	537,623	387,387	72.06%

ZHVILLIMET RREGULLATIVE**2.1 AKTIVITETET RRETH ZHVILLIMIT DHE APROVIMIT TË LEGJISLACIONIT DYTËSOR**

Zyra e Rregullatorit për Energji, në pajtim me mandatin e vet, gjatë vitit 2007 ka vazhduar me kompletimin dhe miratimin e legjislacionit sekondar në formë të rregullave, vendimeve dhe udhëzimeve për krijimin e kornizës rregullative gjithëpërfshirëse për Sektorin Energjisë në Kosovë, ashtu siç është paraparë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe ligjet e tjera të energjisë. Zhvillimi i Kornizës Rregullative pranë ZRRE-së në pjesën me të madhe ka qenë i mbështetur nga projektet e asistencës teknike, të financuara nga donacionet e dhëna nga AER-i dhe USAID-i.

Gjatë vitit 2007 janë përpiluar dhe miratuar këto rregulla:

Procedura e menaxhimit të kodeve teknike/operacionale

Kjo rregull zhvillon procedurat qeverisëse për shqyrtim dhe aprovim të Kodeve Teknike/Operacionale në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë duke përcaktuar mënyrën e themelimit të komisionit për qeverisje të kodeve.

Rregulla mbi informatat konfidenciale

Rregulla përcakton të drejtën e Zyrës së Rregullatorit për Energji që të bëjë përcaktimin nëse një materiali i veçantë përmban informatë konfidenciale si dhe politikën dhe procedurat për përcaktimin dhe qasjen në informatën e tillë konfidenciale.

Gjithashtu gjatë vitit 2007 janë bërë prezantime dhe diskutime publike, të rregullave të cilat pritet të miratohen nga Bordi i ZRRE-së gjatë vitit 2008.

- Rregulla për masat administrative dhe gjobat;
- Rregulla për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese;
- Doracaku i Punës dhe
- Doracaku i raportimit për sektorin e energjisë.

Zyra e Rregullatorit për Energji gjatë vitit 2007, ndër aktivitetet tjera të përditshme, ka shqyrtuar një mori kërkesash dhe ka vendosur për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ndërmarrjet e licencuara: Korporata Energjetike e Kosovës, Operatori i Sistemit të Bartjes dhe Tregut dhe kompanitë për ngrohje qendrore

2.2 AKTIVITETE RRETH LICENCIMIT DHE MONITORIMIT TË OPERATORËVE TË LICENCUAR

Sipas ligjit për Rregullatorin e Energjisë ZRRE-ja ka autoritet të lëshojë, modifikojë dhe tërheqë licencat. Në vazhdim do të paraqiten aktivitetet e ZRRE-së në këtë lëmë:

Gjatë vitit 2007 në Zyrën e Rregullatorit për Energji për marrje të licencës kanë aplikuar një numër mjaft i madh i ndërmarrjeve, nga të cilat disa janë licencuar për *Furnizim/tregti me energji elektrike*, si: *“GSA SHPK”-Shqipëri*,; *“ATEL ENERGY AG”-Zvicër*, dhe *“RUDNAP GROUP A.D” – Serbi*.

Ndërmarrjet që kanë aplikuar dhe nuk kanë marrë licencë për *Furnizim/tregti me energji elektrike* nga se nuk i kanë plotësuar kushtet sipas Rregullës për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, janë: *“MC INVEST CONSULTING” – Serbi*, dhe *“SAS” Energy Enterprise –Zvicër, dega në Kosovë*.

Po ashtu në vitin 2007 është pranuar aplikacioni për licencë i ndërmarrjes: *“KORLEA INVEST A.S” – Republika Sllovaqe*, Furnizim/Tregti me energji elektrike, dhe vendimi për licencim do të bëhet në fillim të vitit 2008.

Deri në fund të vitit 2007 ZRRE-ja ka lëshuar 15 licenca subjekteve juridike. Numri dhe lloji i licencave të lëshuara është si në vijim: katër licenca për gjenerim të energjisë elektrike; një licencë për furnizim publik me energji elektrike; një licencë për shpërndarje të energjisë elektrike; një licencë për bartje të energjisë elektrike; një licencë për operator të tregut të energjisë elektrike; dy licenca për furnizim publik me ngrohje qendrore; dy licenca për gjenerim të ngrohjes qendrore; dy licenca për shpërndarje të ngrohjes qendrore; dhjetë licenca për furnizim/tregti të energjisë elektrike.

Viti 2007 ka qenë viti i parë i plotë pas licencimit të ndërmarrjeve energjetike. ZRRE-ja gjatë kësaj periudhe ka monitoruar këto ndërmarrje, dhe ka përcjellë pajtueshmërinë e aktiviteteve të ndërmarrjeve të licencuara me kushtet e licencës.

Në dokumentin “Doracaku i Raportimit” është përcaktuar mënyra e monitorimit, si dhe afatet kohore tremujore dhe vjetore të raportimit, nga të gjithë të licencuarit. Për të licencuarit në fillim të vitit 2007 ZRRE-ja ka organizuar një tryezë pune ku të licencuarit janë informuar për mënyrën e raportimit dhe afatet kohore të dorëzimit të tyre. Shumica e ndërmarrjeve të licencuara kanë bërë dorëzimin me kohë të këtyre raporteve dhe sipas afateve të parapara, por, ka edhe raste kur disa ndërmarrje nuk kanë arritur t’i dorëzojnë me kohë raportet. Arsytet e mosdorëzimit janë prezantuar si probleme që janë paraqitur për shkak të ndërrimit të stafit në këto ndërmarrje, përkatësisht ndërrimit të personit kontaktues ndërmjet ndërmarrjes së licencuar dhe ZRRE-së. Me insistim të ZRRE-së më vonë janë dorëzuar këto raporte.

Të licencuarve kryesisht u janë lëshuar licenca me kushte për përmbushjen e aktivitetit të tyre. Meqë për arsye të ndryshme nuk ka qenë e mundur të përmbushen disa nga obligimet të cilat dalin nga licenca, atëherë në raste të tilla të licencuarit kanë kërkuar me shkrim nga ZRRE-ja shtyrje të afatit për përmbushje të obligimeve edhe për një

periudhë të caktuar. ZRRE-ja, pas vlerësimit të shkaqeve dhe arsyeve të secilës kërkesë veç e veç ka vendosur për kërkesat e bëra në bazë të specifikave të tyre.

2.3 INFORMIMI I PUBLIKUT

Si synim kryesor i ZRRE-e në aktivitetet për komunikim me publikun, institucionet vendore dhe ato të jashtme ka qenë informimi i saktë dhe transparent për zhvillimet rregullative në Kosovë dhe zhvillimeve përbrenda ZRRE-së. Ligji për Rregullatorin e Energjisë i Kosovës, përkufizon obligimet e rregullatorit për participim të publikut gjatë procesit të vendimmarrjes, hapjen e mbledhjeve të bordit për publik, komunikimi me pjesëmarrësit e tjerë në sektor etj.

Gjatë vitit 2007, të gjitha aktivitetet e ZRRE-së lidhur me mbajtjen e takimeve të Bordit të ZRRE-së kanë qenë të lajmëruara më herët përmes ueb-faqes së saj www.ero-ks.org; gjithashtu vendimet e marra i janë prezantuar publikut nëpërmjet të konferencave për media, pjesëmarrje në emisione speciale televizive për sektor, komunikatave, deklaratave për shtyp, intervistave, letrave të dërguara institucioneve kyçe të sektorit si MEM-it qeverisë, UNMIK-ut si dhe organizatave energjetike. Publiku kryesisht ka qenë i informuar për zhvillimet në tregun e energjisë, tarifat e ngrohjes qendrore, tarifat e energjisë elektrike, kodet teknike të KOSTT-it, vendimet për licencim të aktiviteteve të tregtimit, etj

2.4 VENDIMET E BORDIT TË ZRRE-SË GJATË VITI 2007

Në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Neni 26, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, gjatë vitit 2007 ka mbajtur 16 mbledhje në të cilat janë shqyrtuar çështje që kanë të bëjnë me aktivitetet e ndërmarrjeve të licencuara të energjisë. Ndër më të rëndësishmet janë: miratimi i kodeve teknike; miratimi dhe amendamenti i rregullave të tregut; shqyrtimi i kërkesave për licencim të ndërmarrjeve që kanë aplikuar; miratimi i të ardhurave të lejuara dhe tarifave me pakicë për KOSTT-in, KEK-un, miratimi i tarifave për NQ Gjakova dhe NQ Termokos; miratimi i kontratave për furnizim me ngrohje qendrore; kërkesave lidhur me shfuqizimin e përkohshëm të dispozitave të veçanta të licencave; miratimi i procedurave dhe rregulloreve tjera të ndryshme që kanë të bëjnë me aktivitetet e licencuara, etj. Këto vendime dhe akte janë të publikuara në Buletinin nr. 3 dhe 4 dhe mund të gjinden në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E ENERGJISË

3.1 AKTIVITETE NË SEKTOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Me gjithë burimet e shumta të linjitit që ka, Kosova edhe më tutje ka mungesë të theksuar të energjisë elektrike. Sektori i energjisë elektrike mbetet i dominuar nga Korporata Energjetike e Kosovës, që është ende në hapat e parë të shthurjes.

Synim afatgjatë kryesor i prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë është mbulimi i të gjithë konsumit vendor me energji elektrike kualitative, stabile dhe pa ndërprerje e me çmime konkurrense, si dhe eksportimi i tepicës së energjisë elektrike në tregun rajonal dhe më gjerë. Për të arritur këto synime nevojitet funksionimi normal i centraleve ekzistuese duke i riparuar ato, dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese.

Kosova si nënshkruese e Marrëveshjes së Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore, ka bërë një progres në zhvillimin dhe monitorimin e liberalizimit të tregut të energjisë në përputhje me kërkesat e traktatit. Progres është arritur edhe në drejtim të shthurjes së kompanisë vertikalisht të integruar, KEK-ut. Nga data 1 korrik 2006, KOSST-i operon si entitet i veçantë i bartjes (transmisionit), dhe si i tillë është i licencuar nga Zyra e Rregullatorit për energji, si Operator i Tregut dhe Operator i Sistemit të Bartjes. Nga konditat e licencës del se KOSTT-i duhet t'i mbajë llogaritë e ndara veç për Operatorin e Tregut dhe veç për Operatorin e Sistemit të Bartjes.

Në Fig. 3.1 janë treguar aktivitetet të cilat janë të rregulluara momentalisht e të cilat marrin pjesë në liberalizimin e tregut dhe më vonë ato do t'i nënshtrohen konkurrencës si dhe ato të cilat duhet të rregullohen edhe në të ardhmen, siç janë bartja dhe shpërndarja (distribuími).




Fig. 3.1 Fushat e rregulluara dhe konkurruese

Me licencimin e aktiviteteve të KEK-ut nga ana e ZRRE-së kërkohet që kjo ndërmarrje të ketë të ndara llogaritë për aktivitete si gjenerimi, furnizimi dhe shpërndarja. Në të ardhmen këto duhet të jenë të ndara (shthurura) plotësisht, ashtu siç kërkohet në legjislacionin Kosovar dhe Direktivat e Unionit Evropian.

Çështje kyçe gjatë vitit 2007 edhe më tutje kanë qenë humbjet si ato teknike dhe ato jo teknike si dhe niveli i ultë i arkëtimit të energjisë elektrike të faturuar. Për të rritur

përqindjen e arkëtimit, KEK-u ka paraqitur skemën e shkyçjeve “ABC”, e cila për dallim nga skema e mëparshme e reduktimit të energjisë, e cila i trajtonte të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë, bënë dallimin e konsumatorëve më nivel më të lartë të pagesës (kategoria A), ata me nivel mesatar (kategoria B) dhe paguesit më nivel të ultë (kategoria C). Kategorizimi është bërë në nivel të furnizimit 10 KV, në bazë ekonomike. KEK-u është duke planifikuar të transferojë skemën ABC nga niveli i furnizimit 10 kV në nivelin e rrjetit të tensionit 0.4 kV.

3.2 TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

Kosova gjatë vitit 2007 ka pasur mungesë të energjisë elektrike dhe si pasojë ka pasur reduktime të theksuara të konsumit. Shkalla e zhvillimit të tregut në Kosovë ka qenë e kufizuar nga mungesa e energjisë dhe ekzistenca e një prodhuesi të vetëm të energjisë elektrike. Megjithatë, janë bërë disa hapa konkretë në hapjen e tregut. Rregullat e tregut të krijuara qysh më parë kanë filluar të implementohen. Po ashtu gjatë vitit 2007 janë hartuar shumë dokumente nga ana e KOSTT-it që rregullojnë funksionimin më të mirë të sistemit energjetik dhe ndihmojnë në përcaktimin e kushteve të punës në një treg të hapur. Pjesa më e madhe e këtyre dokumenteve është aprovuar nga ZRRE-ja. Në këtë kategori hyjnë: kodet teknike, procedura të ndryshme, plane zhvillimore dhe investive etj.

Hapje konkrete e tregut është bërë me procesin e fitimit të statusit të konsumatorit të kualifikuar (privilegjuar):

- Kështu nga data 1 janar 2006 konsumatorët e kyçur në tensionin 110 kV e më lartë kanë të drejtën të fitojnë statusin e konsumatorit të kualifikuar. Këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar dy konsumatorë të mëdhenj në Kosovë, “Alferoni” (ish-Feronikeli) në Drenas dhe “Sharrceci” në Han të Elezit.
- Nga data 1 janar 2007 këtë status kanë pasur të drejtë ta gëzojnë konsumatorët e kyçur në tensionin 35 kV e më lartë.
- Ndërsa nga data 1 janar 2008 këtë status mund ta gëzojnë konsumatorët e kyçur në tensionin 10 kV e më lartë.

Gjatë vitit 2007 nuk është vërejtur ndonjë interesim i konsumatorëve për fitimin e statusit të konsumatorit të kualifikuar. Me iniciativën e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe në bashkëpunim me ZRRE, KOSTT dhe KEK-un, janë mbajtur takime me konsumatorë të mëdhenj industrial, si dhe është mbajtur një punëtori me qëllim të njohjes së këtyre konsumatorëve për mundësitë dhe përparësitë që siguron statusi i konsumatorit të kualifikuar.

Gjendja aktuale e kapaciteteve prodhuese dhe transmetuese të sistemit në Kosovë është si vijon: Kapacitetet prodhuese operative konsiderohet të jenë rreth 970 MW, prej të cilave kapacitete termike 927 MW dhe ujore 43 MW. Këto nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e konsumit gjithnjë në rritje, e posaçërisht në kohën e pikut në sezonin dimëror kur konsumi është dukshëm më i lartë si pasojë e përdorimit të energjisë për ngrohje.

Tab. 3.1 Kapacitetet operative të TC dhe HC

	Viti i konstruktimit	Kapaciteti i dizajnuar	Kapaciteti operativ	
			Gjenerator	Sistem
A1	1962	65	35	32
A2	1964	125	-	-
A3	1970	200	135	120
A4	1971	200	135	120
A5	1975	210	145	130
TC Kososva A		800	450	402
B1	1983	339	290	265
B2	1984	339	280	260
TC Kososva B		678	570	525
HPP Ujmani	1981	35	35	35
HPP Lumbardhi	1957/2005	8	8	8
Total		1521	1063	970

Përveç kapaciteteve prodhuese kufizime ka edhe në kapacitetet transmetuese që janë të theksuara posaçërisht në disa rajone, si Dukagjin dhe Anamoravë.



Fig. 3.2 Rrjeti i bartjes në Kosovë

Edhe kapacitetet transmetuese në nivelin e shpërndarjes janë po ashtu me kufizime, dhe kërkojnë investime të konsiderueshme.

Tab. 3.2 Kapacitetet transmetuese

Transmisioni	Njësia	Niveli i tensionit		
Tensioni	kV	400	220	110
Gjatësia	km	181	361	643.5
Transformimi	kV/kV	400/220	220/110	220/35/10(20)
Kapacitetet transformuese	MVA	1200	1000	400

Në rajon nuk ka pasur ndonjë aktivitet të posaçëm rreth hapjes së tregut rajonal dhe bashkëpunimit në këtë drejtim.

3.3 PRODHIMI DHE SHPENZIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

■ Prodhimi i linjitit

Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë është i bazuar në termocentrale të cilat kanë për bazë linjtin, dhe atë me rreth 98%, ndërsa pjesa tjetër prej 2% mbulohet nga hidrocentralet. Por me gjithë rezervat e mëdha të linjtit aktualisht dy mihjet e hapura të linjtit që funksionojnë nga viti 1962 tani paraqiten si një faktor kufizues në prodhimin e mjaftueshëm të energjisë elektrike. Tash për tash këto dy mihje furnizojnë dy termocentralet me kapacitet rreth 7 milion tonelata për vit. Nga kjo sasi një pjesë fare e vogël shfrytëzohet në tregun e lirë. Pritet që këto mihje të shfrytëzohen plotësisht deri në vitin 2012, ose ndoshta edhe më herët, prandaj intensifikimi i hapjes së mihjes së re ne juglindje të Sibovcit është prioritet absolut, për të cilën janë kryer hulumtimet e nevojshme.




Fig. 3.3 Prodhimi dhe konsumi i linjitit 2007

Tab. 3.3 Prodhimi dhe konsumi i linjitit 2007

Prodhimi & Konsumi i Lnjtit	Realizimi 2005	Realizimi 2006	Realizimi 2007	Bilanci 2007	Realiz/Bilanci 2007	Realizimi 2007/2006
Gjithsej prodhimi i linjitit (t)	6,536,759	6,532,355	6,715,352	6,960,000	96.48%	102.80%
Gjithsej konsumi i linjitit (t)	5,796,658	5,830,253	6,824,892	6,104,700	111.80%	117.06%

Me hapjen e kësaj miniere do të zgjidhej për një kohë më të gjatë çështja e furnizimit me linjit të centraleve ekzistuese por edhe atyre që planifikohen të ndërtohen.

■ Prodhimi i energjisë elektrike

Kapaciteti i instaluar teknik, siguria dhe gatishmëria e punës në dy termocentralet Kosova A dhe Kosova B është zvogëluar dukshëm për shkak të vjetërsisë dhe mirëmbajtjes joadekuate në periudha të ndryshme kohore. Kështu A1 si njësia më e vjetër punon me një kapacitet të zvogëluar dhe me efikasitet fare të ultë dhe ndotje të madhe të ambientit, prandaj përdorimi i saj mbetet vetëm për raste tejet emergjente. Njësia A2 ka probleme në konstruksionin bazë ndërtimor dhe transformatorin bllok, që është dekomisionuar.

Tab. 3.4 Prodhimi i energjisë elektrike neto për periudhën 2004 - 2007

Prodhimi / Njesite prodhuese	Realizimi 2004 (MWh)	Realizimi 2005 (MWh)	Realizimi 2006 (MWh)	Realizimi 2007 (MWh)	Bilanci 2007 (MWh)	Realiz/Bilanci 2007 (MWh)
A1	6 300	64 542	7,609	-5,932	0	
A3	320 600	- 2 775	347,551	653,485	241,920	270.12%
A4	130 000	- 1 167	-1,046	565,878	561,600	100.76%
A5	519 200	584 350	544,416	10,379	133,920	7.75%
TC Kososva A	976 100	644 950	898,529	1,223,810	937,440	139.32%
B1	1 587 500	1 476 759	1,376,516	1,726,957	1,612,764	107.08%
B2	1 207 400	1 767 575	1,595,667	1,288,556	1,455,408	88.54%
TC Kososva B	2 794 900	3 244 334	2,972,182	3,015,513	3,068,172	91.61%
Sh.A. Kosova Thengjilli		778	0		25,000	0.00%
HC Ujmani	113 300	109 682	99,562	70,076	88,000	79.63%
Hc Distributive		0	26,624	23,588	37,781	62.43%
Total Prodhimi	3,884,300	3,999,744	3,996,897	4,332,987	4,156,393	99.93%
Marrje (Imp+Shk)	483 580	490 632	536,238	642,349	673,280	95.41%
Dhenje (Eksp+Shk)		225 965	252,527	378,868	92,569	409.28%

Njësitë A3 dhe A4 janë në gjendje më të mirë dhe janë shfrytëzuar gjatë vitit 2007, alternativisht, por ka pasur edhe periudha kur kanë qenë të dyja në funksion. Njësia A5 ka punuar shkurt në fillim të vitit 2007 dhe pastaj kanë filluar punët rehabilituese në të.

Të gjitha njësitë në Kosova A kanë efikasitet të ultë të shfrytëzimit të linjitet që sillet rreth (1.9 – 2) t/MWh.

Njësitë në TC Kosova B janë në gjendje më të mirë dhe kanë një efikasitet më të lartë, e cila sillet nga (1.4 – 1.5) t/MWh.

Jashtë KEK-ut është në funksion Hidrocentrali Ujmani 35 MW (2 njësi me nga 17.5 MW), i administruar nga kompania e ujit Hidrosistemi “Ibër-Lepenc” në Prishtinë.

Po ashtu në punë është edhe hidrocentrali “Lumëbardhi” me kapacitet 8 MW, 2 njësi me nga 4 MW. Ky central është në pronësi të KEK-ut ndërsa menaxhohet nga “Triangle General Contractors Inc.” sipas kontratës 20-vjeçare për qiradhënie dhe marrëveshje për shitje të energjisë me KEK-un.

HC Lumëbardhi dhe Radavci me fuqi të vogël janë HC të kyçura në rrjetin e shpërndarjes.




Fig. 3.4 Realizimi i prodhimit gjatë vitit 2007

Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2007 është realizuar sipas planit, me disa përjashtime të vogla, për shkak të ndryshimit kohor të riparimeve të njësive prodhuese, e posaçërisht shtyrjes dhe zgjatjes së afatit të remontit të njësisë B2, që është kërkuar nga kompania "ALSTOM" Francë.

Prodhimi i energjisë elektrike në TC në krahasim me vitin 2006 ka pasur një ngritje prej 9.5 % Kështu prodhimi në prag të TC në vitin 2006 ka qenë 3 872 GWh ndërsa në vitin 2007 ka qenë 4 239 GWh. Prodhimi në HC ka pasur një rënie prej 25.8%, si pasojë e një viti të thatë, mirëpo ajo ka pak ndikim në prodhimin e gjithmbarshëm, të energjisë elektrike në vitin 2007. Mund të përfundohet se gjatë vitit 2007 krahasuar me vitin 2006 ka pasur një rritje të prodhimit të energjisë elektrike për 8.4%.

Tab. 3.5 Konsumi sipas kategorive tarifore në vitin 2007

Kategoria	MWh	Nr.konsumatorëve
110 kV (Alferoni, Sharrcem, Trepça)	199,070	3
35 kV	33,419	14
10 kV	156,011	217
Amvisnia nën 200 kWh/muaj dhe Spitalet	323,937	302,742
Amvisnia prej (201kWh deri ne 600kWh)/muaj	766,040	
Amvisnia mbi 600 kWh/muaj	323,361	
0.4 kV I	122,236	905
0.4 kV II	267,290	52,550
Ndriqimi publik	7,468	465
Konsumatorët në amvisni pa njehësor	80,602	11,497
Konsumatorët me parapagim ne avsn	12,946	33
Konsumatorët komercial me parapagim	63	19
Total	2,292,443	368,445

Konsumi po ashtu ka shënuar një rritje prej rreth 7.4% krahasuar me vitin 2006. Kjo rritje është më e madhe nëse merret parasysh energjia e futur në shpërndarje dhe te

konsumatorët e drejtpërdrejtë, dhe arrin vlerën 8.3%.

Përveç në shpërndarje (distribucion), rritje të konsumit kanë pasur edhe konsumatorët e kualifikuar dhe konsumatorët e drejtpërdrejtë. Kjo posaçërisht është influencuar nga “Alferoni” (Feronikeli) i cili ka pasur rritje të konsumit të energjisë në krahasim me një vit më parë.




Fig. 3.5 Realizimi i konsumit dhe humbjet gjatë vitit 2007

3.4 IMPORTI DHE EKSPORTI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Operatori i furnizimit i KEK-ut, në mungesë të energjisë elektrike, ka realizuar importe. Këto importe gjatë vitit 2007 janë përcjellë me një ngritje me hop të çmimit të importit në mesatare nga 54.87 €/MWh në vlerën 83.66 €/MWh, në radhë të parë si pasojë e mungesës së energjisë në rajon, aplikimit të pagesës për alokim të kapaciteteve transmetuese interkonektive për rastet e kongjesionit (fytëve të ngushta) dhe faktit se Kosova importon energji për nevoja të balancimit të ngarkesës së pikut. Këto nevoja janë në disproporcion të madh me nevojat jashtë pikut. Kësaj duhet t'i shtohet edhe mungesa e rezervës terciare, që manifestohet në sisteme të vogla, siç është rasti edhe i Kosovës, me njësi të mëdha prodhuese termike.

Gjatë importeve të energjisë elektrike Kosova ka pasur kufizime dhe mosmarrëveshje rreth aplikimit të pagesës me Serbinë, dhe si pasojë realizimi i alokimit të kapaciteteve për nevojat e importit dhe eksportit të energjisë elektrike për KEK-un është bërë vetëm nga tregtarët.

Më poshtë është dhënë tabela dhe grafiku i vëllimit të importeve për vitet 2000 – 2007 si dhe çmimet mesatare të importit.

Tab. 3.6 Importi në periudhën 2000 - 2007

KEK Import	Vëllimi	Çmimi	Vlera	Vlera
Year	MWh	(\$)/MWh	€	mil Euro
2000*	778 870	30.43	23 701 412	23.7
2001*	921 485	29.60	27 276 960	27.3
2002*	627 265	32.67	20 491 605	20.5
2003	314 794	44.53	14 016 421	14.0
2004	483 580	39.64	19 169 111	19.2
2005	349 335	47.87	16 723 315	16.7
2006	393 054	54.87	21 566 342	21.3
2007	539 812	83.66	45 161 222	45.2
Total	4 408 195	42.67	188 106 387	187.9

Shënim: Më 2000 - 2002 çmimet janë në dollarë amerikanë (\$) me një kurs këmbimi prej rreth 1:1




Fig. 3.6 Importi dhe çmimet në periudhën 2000 – 2007

Tab 3.7 Shkëmbimi, importi dhe eksporti i energjisë elektrike gjatë vitit 2007

Muaji	Shk.dhënje	Shk.marrje	Eksport			Import			Total dhënje	Total marrje	Total
Njësia	Sasia MWh	Sasia MWh	Sasia MWh	Vlera €	Çmimi mesatar i eksportit €/MWh	Sasia MWh	Vlera €	Çmimi mesatar i importit €/MWh	Sasia MWh	Sasia MWh	Sasia MWh
1	5,554	0		0		58,800	4,817,925	81.94	5,554	58,800	-53,246
2	13,690	2,609		0		83,232	6,677,652	80.23	13,690	85,841	-72,151
3	11,785	5,158		0		52,544	4,035,227	76.80	11,785	57,702	-45,917
4	40,138	650		0		19,328	1,312,790	67.92	40,138	19,978	20,160
5	24,446	1,720	96,417	3,472,342	36.01		0		120,863	1,720	119,143
6	10,957	3,750	71,910	2,993,398	41.63		0		82,867	3,750	79,117
7	17,995	5,630		0	41.63	29,280	2,653,167	90.61	17,995	34,910	-16,915
8	34,550	11,920	1,848	77,805	42.10	40,640	3,723,302	91.62	36,398	52,560	-16,162
9	3,790	20,400		0		128,728	11,127,883	86.44	3,790	149,128	-145,338
10	21,798	11,960		0		81,360	6,636,804	81.57	21,798	93,320	-71,522
11	3,720	9,590		0		26,556	2,501,563	94.20	3,720	36,146	-32,426
12	1,310	10,190		0		19,344	1,674,908	86.59	1,310	29,534	-28,224
Total	189,733	83,577	170,175	6,543,546	38.45	539,812	45,161,222	83.66	359,908	623,389	-263,481

Duhet të theksohet se gjatë këtij viti ka pasur mos-harmonizime ndërmjet prodhimit vetanak të energjisë elektrike dhe tenderimeve për importe, të cilët janë realizuar vetëm pjesërisht. Çmimet e energjisë elektrike në rajon kanë pësuar rritje, dhe kjo ka pasur si pasojë edhe ngritjen e çmimeve të blerjes së energjisë nga ana e KEK-ut. Tabela 3.7 paraqet të gjitha shkëmbimet e energjisë në baza mujore gjatë vitit 2007, përfshirë këtu edhe çmimet.

Deri në muajin gusht 2007, energjia që ka hyrë në Kosovë ka qenë më e vogël se ajo që ka dalë, praktikisht Kosova nga janari 2007 deri në gusht 2007 ka qenë vend eksportues i energjisë; por në muajt vijues kjo situatë ka ndryshuar rrënjësisht.

Energjia si import + shkëmbim (marrje) deri në fund të Gushtit 315 261 MWh,
Energjia si eksport + shkëmbim (dhënie) deri në fund të Gushtit 329 290 MWh.




Fig. 3.7 Importi dhe eksporti me kontrata dhe çmimet në vitin 2007




Fig. 3.8 Importi dhe shkëmbimi (marrje) 2007,

Fig. 3.9 Eksporti dhe shkëmbimi (dhënie) 2007

Importi dhe eksporti është realizuar kryesisht përmes kontratave, dhe shkëmbimeve të energjisë. Shkëmbimet janë realizuar përmes OST-ve të vendeve fqinje, si Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia, dhe kryesisht në bazë ditore. Në shumë raste kjo energji konsiderohet si emergjente dhe ka një koeficient të kthimit relativisht të lartë, me një raport afër 1 me 2. Një shkëmbim i tillë më së shumti ka qenë praktikë me EMS

(Serbi). Nga kjo del se sasia e energjisë që është marrë nga Serbia është shumë më e vogël se ajo që është kthyer

3.5 HUMBJET NË SISTEMIN ELEKTROENERGJETIK TË KOSOVËS

Humbjet në rrjetën e bartjes dhe të shpërndarjes janë faktorë përcaktues që kanë ndikim në sasinë e shpenzimit të energjisë, në furnizimin e rregullt të konsumatorëve, në çmim kushtues të energjisë, si dhe në mbingarkesat e linjave dhe të transformatorëve. Ndërkaq në rrethanat tona për furnizim të mjaftueshëm të konsumit kosovar, humbjet shkaktjnë rritjen e importit të energjisë elektrike. Problemi i humbjeve në rrjet, përkundër angazhimeve të stafit të KEK-ut në vitin 2007, bartet edhe në vitin 2008, pa ndonjë ndryshim thelbësor, si një problem që kërkon një qasje sistimore institucionale.

Vlen të theksohet se humbjet në bartje janë të ndikuara edhe nga tranziti i energjisë që kalon nëpër sistemin transmetues të Kosovës. Kjo pjesë e humbjeve duhet të kompensohet nga tranzituesit e që në këtë rast janë vendet nga rajoni. Kompensimi për këtë bazohet në mekanizmin e Kompensimit ndërmjet Operatorëve të Bartjes, të rrjedhave të energjisë nëpër interkoneksion. KOSTT-i është duke bërë përpjekje për këtë kompensim nga EMS i Serbisë, përmes takimeve të monitoruara nga ETSO, por deri me tash nuk ka pasur rezultate në sajë të sjelljes obstruktive të EMS. EMS ka inkasuar nga rajoni të hyra për tranzitin nëpër Kosovë, ndërsa mirëmbajtja dhe humbjet e shkaktuara nga ky tranzit mbetën barrë e KOSTT-it, dhe kjo çështje mbetet peng i marrëdhënieve ndërmjet KOSTT-it dhe EMS-it.

Tab. 3.8 Humbjet e energjisë në periudhën 2005 – 2007

Viti	2005	2006	2007
Përshkrimi	GWh	GWh	GWh
Humbjet në transmision	276	280	267
Energjia e futur në distribucion	3,883	3,896	4,036
Humbjet në distribucion	1,873	1,850	1,942
Distrib. Teknike	582	584	702
Distrib. Jo-teknike	1,291	1,266	1,239
Humbjet total	2,149	2,130	2,209

Humbjet në shpërndarje janë të karakterizuara nga: *humbjet teknike* dhe *humbjet jo teknike*. Zvogëlimi i humbjeve si atyre teknike po ashtu edhe atyre jo-teknike ka qenë dhe do të mbetet si prioritet për këtë operator.

Tab. 3.9 Humbjet e energjisë gjatë vitit 2007

Humbjet	Njesia	janar	shkurt	mars	prill	maj	qeshor	korrik	gusht	shtator	tetor	ntor	dhjetor	Totali
Bartje	MWh	37,703	37,746	34,802	16,893	15,196	13,652	14,202	13,967	12,121	18,320	19,984	31,947	266,533
Distribicion	MWh	239,250	208,014	215,376	152,352	117,986	88,482	85,421	87,410	97,189	171,933	220,911	257,380	1,941,704

Duhet theksuar se humbjet në përgjithësi deri më tash kanë qenë pak të trajtuara për shkak se KEK-u ka qenë ndërmarrje vertikalisht e integruar. Mirëpo me fillimin e

shthurjes tarifore vërehet kërkesa për përcaktimin e humbjeve në mënyrë më të saktë, dhe se kush duhet t'i mbulojë këto humbje.




Fig 3.10 Humbjet në Bartje dhe Shpërndarje në vitin 2007

3.6 AKTIVITETET PËR VENDOSJEN E TARIFËS PËR ENERGJI ELEKTRIKE

Reforma tarifore, paraqet, njërin nga aktivitetet themelore në vijën e synimeve të strategjisë zhvillimore të sektorit të energjisë elektrike. Vendosja e sistemit të ri tarifor, që reflekton kostot reale, krahas aktiviteteve tjera është përcaktuar me legjislacionin si në vazhdim: Nenet 45 deri në 48 të “Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë” Nr. 2004/9, Dispozitat e Rregullit mbi Parimet Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve) si dhe; Metodologjisë së Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike.




Fig..3.11 Qasja e ndërtimit të blloqeve për kostot e lejuara

Metodologjia e Tarifave bazohet në parimet e dhëna në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe ajo është zhvilluar duke marrë parasysh: Mbulimin e kostove të arsyeshme të operimit dhe mirëmbajtjes dhe Rikthimin e financimit komercial të aseteve (kostot e kapitalit).

Duke zbatuar parimet e Metodologjisë së tarifave, të ardhurat vjetore të lejuara llogariten sipas parimit të “bloqeve të ndërtesës”, të treguar në diagramin Fig.3.11.

3.6.1 STRUKTURA E TARIFAVE ME PAKICË

Tarifat e shitjeve me pakicë për konsumatorët e fundit janë një kombinim i tarifës së furnizimit dhe tarifës së shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes. Secila nga tarifat e shitjeve me pakicë janë të përbëra nga elementet që pasqyrojnë kostot dhe të cilat mund të maten, ose të cila përmbajnë një ose më shumë klasë të kostove.

Tarifat me pakicë përfshijnë:

- Tarifat e energjisë, të shprehura në €/kWh, me norma të ndryshme, që aplikohen në sezonin dimër/verë dhe ditë/natë. Këto tarifa mbulojnë kostot e ndryshueshme të furnizimit (kostot e karburantit, të gjenerimit dhe kostot e importit të energjisë).

Kostot e përgjithshme të energjisë, paraqesin shumën e kostove të lejuara të operatorit të tregut (OT) dhe kostot e operatorit të sistemit (OS) të shpërndara tek konsumatorët jo të kualifikuar dhe kostot e përgjithshme të blerjes së energjisë, duke zbritur pjesën që konsiderohet se ka të bëjë me kërkesën (fuqinë e angazhuar) .

Për konsumatorët e tjerë, kostot e shpërndara të kërkesës më pas i shtohen tarifave të energjisë të llogaritura si më sipër. Përbërësi i kapacitetit të kostove të blerjes së energjisë i shtohet tarifave të energjisë të aplikuara në periudhat e larta (dimër dhe verë). Përbërësi i kapacitetit të tarifave të (SHST) dhe të shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes (SHSSH) i shtohet tarifave të energjisë të aplikuara në të gjitha periudhat.

Për konsumatorët shtëpiakë (kategoritë 5-6), janë bërë dy ndryshime, si në vazhdim¹:

- Për të mbajtur raportin ekzistues midis tarifave të periudhave të ulëta dhe të larta, e që është dy me një (vendim i marrë për të rritur përshtatjen), tarifat e sezonit të lartë dhe të ulët janë rillogaritur në mënyrë që raporti midis dy periudhave në secilin sezon të mbetet sërish dy me një.
- Është miratuar struktura me tre blloqe për konsumatorët shtëpiakë

Tarifat e energjisë reaktive për konsumatorët në kategoritë 1-3, janë llogaritur si:

¹ Ka edhe një rregullim të mëtejshëm për të shndërruar tarifat përfundimtare të dy periudhave dhe dy sezoneve në një tarifë për një sezon dhe një periudhë për konsumatorët me njehsorë një-normësh .

- Tarifat të energjisë reaktive, për konsumatorët më të mëdhenj me matje të përshtatshme, (të shprehura në €/kVArh). Tarifat e energjisë reaktive mbulojnë kostot e sigurimit të energjisë reaktive.

Shqyrtimi i parë i tarifës së energjisë elektrike (ShTE 1) solli një sërë ndryshimesh në krahasim me strukturën e mëparshme të tarifave me pakicë:

■ **Tarifat fikse për konsumatorë**

Tarifat fikse, të shprehura në €/konsumator/muaj, përdoren për të mbuluar kostot e furnizimit që kanë të bëjnë me: leximin e njehsorit, faturimin, arkëtimin, shërbimet e Informacionit (siç është promovimi i efikasitetit të energjisë) dhe kosto tjera operative.

■ **Tarifat e kërkesës për fuqi të angazhuar**

Tarifat e Fuqisë për konsumatorët në kategoritë 0-3 (konsumatorë të mëdhenj industrialë dhe komercialë) janë kosto që shkaktohen për të përmbushur kërkesat maksimale (kW) për konsumatorët në secilin nivel funksional të gjenerimit, të bartjes dhe të shpërndarjes.

- Tarifat e kërkesës (fuqisë), për konsumatorët me matje (të shprehura në €/kW dhe të aplikuara për kërkesë të fuqisë) e matur gjatë pikut për secilin muaj. Kjo tarifë mbulon kostot (fikse) të furnizimit të shkaktuara nga kërkesa e fuqisë gjatë pikut (pra, siguri i kapaciteteve të rrjetit dhe gjenerimit).

■ **Tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit**

ZRRE-ja përveç përcaktimit të tarifave me pakicë, ka përcaktuar edhe tarifat e shfrytëzimit të sistemit të transmetimit,

- Tarifa e kapacitetit (infrastrukturës), të cilat mbulojnë kostot e investimit, mirëmbajtjes së aseteve të përgjithshme të rrjetit, kostot direkte operative të sistemit të OST-së, duke përfshirë zyrat, stafin, harduerin, softuerin, kostoja e blerjes së shërbimeve ndihmëse dhe energjisë për të mbuluar humbjet në rrjet.
- Të gjithë shfrytëzuesit e sistemit përfitojnë nga shërbimet e operatorit të sistemit, prandaj duhet të kontribuojnë në rigjenerimin kostove direkte të operatorit të sistemit. Pra, prodhuesit dhe konsumatorët që ngarkojnë rrjetin bëjnë pagesa për SHST-në për të rigjeneruar këto kosto.
- Tarifat e operatorit të tregut mbulojnë kostot e KOSTT SH.A -së në rolin e vet si OT. Tarifa është llogaritur si kosto totale që ka të bëjë me OT-në, pjesëtuar me shumën e energjisë së parashikuar që hynë në sistemin e bartjes nga burimet kosovare dhe që del nga sistemi i bartjes në të gjithë pikat, për të dhënë një

tarifë të shprehur në €/kWh. Po ashtu tarifat e operatorit të tregut paguhen nga prodhuesit dhe furnizuesi.

3.6.2 PËRMBLEDHJA E PROCESIT TË APROVIMIT TË TARIFAVE

Ashtu siç është definuar në Metodologjinë e Tarifave dhe Rregullën e Çmimeve, shqyrtimi i tarifës ka mbuluar periudhën trevjeçare në shqyrtimin e parë dhe më pastaj shqyrtimet e ardhshme bëhen për periudha pesë vjeçare. Aktualisht periudhat kohore të shqyrtimit së pari definojnë të ardhurat e lejuara për çdo vit veç e veç dhe në bazë të të cilave ndërmarrjet energjetike për çdo vit aplikojnë për tarifë të re. Meqenëse në rastin e Kosovës bëhet shqyrtimi i parë në pajtim me legjislacionin bazë tanimë të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, andaj ky shqyrtim ka mbuluar periudhën kohore tre vjeçare dhe atë: 2007 -2009.

Të ardhurat e lejuara të llogaritura si kosto të vijave buxhetore shpenzuese janë ato parametra, që monitorohen nga ZRRE-ja, meqenëse ato janë përcaktues gjatë llogaritjes së tarifës dhe ZRRE-ja është e interesuar që këto vija buxhetore shpenzuese të vihen në parametrat që duhet të sigurojnë qëndrueshmëri në furnizimin me energji elektrike në të ardhmen. Kjo bëhet, duke u kujdesur që të sigurohet baza financiare, që kualiteti i shërbimit të avancohet.

Meqenëse gjatë shqyrtimit të të hyrave të lejuara llogaritja e kostove është bërë sipas aktiviteteve të licencuara d.m.th. gjenerimit (të cilit i bashkëngjitet kostoja e furnizimit me linjit), bartjes, shpërndarjes dhe furnizimit, atëherë është krijuar edhe baza e tarifave të shturura dhe në këtë mënyrë ato bëhen të kontrollueshme. Kostot e alokuara sipas aktiviteteve dhe tarifat e shturura janë më të kontrollueshme dhe përfshijnë caqet që mund t'i vendosen edhe KEK SH.A-së edhe KOSTT SH.A-së, të cilat do të jenë të rëndësishme gjatë analizës së rezultateve dhe marrjes së masave efektive të përmirësimit të tyre.

Të ardhurat e lejuara gjithashtu janë të vendosura në bazë të performancave dhe do të monitorohen nga ZRRE-ja gjatë tërë periudhës. Me 21 Dhjetor 2006 ZRRE ka lëshuar Vendimin mbi të ardhurat e lejuara të KEK SH.A-së dhe KOSTT SH.A-së. Komentet, sugjerimet dhe të dhënat shtesë të pranura e të rëndësishme nga Qeveria për të Ardhurat e Lejuara: subvencionimi, mbështetja e rasteve sociale, investimet (PIP), që nga 12 Shtatori 2006 deri më datën 20 Dhjetor janë marrë parasysh .

3.6.3 PROCESI DHE ORARI I MIRATIMIT TE TARIFAVE TE RREGULLUARA

Duke përdorur të ardhurat e lejuara e të aprovuara, ZRRE-ja ne bashkëpunim me konsulencën ndërkombëtare kanë përgatitur orarin e shqyrtimit dhe miratimit te tarifave duke u bazuar ne legjislacionin përkatës. Shqyrtimi i çmimeve filloj me një njoftim publik të datës 24 janar 2007.

Datat kyçe më të rëndësishme të procesit të shqyrtimit dhe miratimit të tarifave për në vitin 2007 janë:

Me 23 shkurt 2007 Aplikimi nga KEK SH.A dhe KOSTT-SH.A në bazë të të hyrave të lejuara paraprakisht nga Bordi i ZRRE, me 21 dhjetor 2006.

Me 15 mars 2007 ZRRE-ja ka vendosur të aprovojë tarifën me pakicë për KEK SH.A dhe tarifën e bartjes për KOSTT SH.A.

Publikimi i vendimeve të ZRRE-së në faqen elektronike për tarifën me pakicë të KEK SH.A dhe tarifave për bartje të KOSTT SH.A janë publikuar me datë 15 mars 2007.

Me datë 19 mars 2007, ZRRE-ja ka informuar palët e interesuara rreth aplikacioneve të KEK SH.A dhe KOSTT SH.A, ndërsa njoftimin për media ZRRE-ja e ka bërë me datë 28 mars 2007.

Pas nxjerrjes së këtyre vendimeve, është kërkuar një rishqyrtim nga KEK SH.A dhe KOSTT SH.A në bazë të informacioneve të reja të cilat sugjerojnë që të ardhurat e lejuara mund të jenë më të vogla se ato që është kërkuar nga secila ndërmarrje energjetike për vitin 2007.

Më 25 prill 2007 KEK SH.A dhe KOSTT SH.A i kanë dërguar zyrtarisht kërkesën ZRRE-së për modifikimin e vendimit paraprak për të ardhurat e lejuara. Vlera e reviduar në kërkesën e KEK SH.A dhe KOSTT SH.A ka qenë përafërsisht 5% më e ulët se vlera e të hyrave paraprakisht të aprovuara, si një plotësim i aplikacionit origjinal i dorëzuar nga ana e KEK SH.A me datë 19 shkurt 2007. Në këtë rast, nga shumë palë të interesuara, u ngritën shumë çështje lidhur me strukturën tarifore, në kontekst të angazhimit të KEK SH.A që të shndërrohet në një ndërmarrje të orientuar komerciale dhe me qëllim të përmirësimit të matjes së energjisë elektrike, faturimit dhe arkëtimit të saj.

Me datë 07 maj 2007, Bordi i ZRRE ka nxjerrë Vendimin me të cilin ka vendosur që të merr përsëri në konsideratë vendimin paraprak lidhur me nivelin e të hyrave të Lejuara për KEK SH.A dhe KOSTT SH.A, dhe ka ftuar ndërmarrjet që t'i propozojnë dhe dorëzojnë ZRRE-së tarifën e azhurnuara me pakicë dhe ato të bartjes, në mënyrë që të rishikohen nga Bordi i ZRRE-së si pjesë e procesit të rishqyrtimit.

Duke u bazuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe Vendimeve të aprovuara nga Bordi i ZRRE-së, KEK SH.A ka dorëzuar me 10 maj:

- Aplikacionin për Tarifa të reviduara KEK SH.A Furnizimi–tarifat me pakicë
- Aplikacionin për Tarifa të reviduara KEK SH.A. Shpërndarja, për shfrytëzimin e rrjetit të shpërndarjes.

Duke u bazuar në të Ardhurat e reviduara vjetore KOSTT SH.A ka aplikuar për tarifa të reviduara për tre njësitë e saj më 10 maj: Operatorin e Bartjes, Operatorin e sistemit dhe Operatorin e Tregut.

Më 31 maj 2007, Bordi i ZRRE-së ka rishqyrtuar dhe ka marrë vendim mbi kërkesat e KEK SH.A dhe KOSTT SH.A lidhur me reduktimin e të hyrave të lejuara të tyre, dhe në pajtim me këtë ka miratuar tarifat me pakicë të energjisë elektrike për KEK SH.A dhe tarifat e bartjes për KOSTT SH.A.²

Me 10 tetor 2007 është bërë Njoftimi për Shqyrtimin e dytë të tarifave të energjisë elektrike 2 (ShTE2), dhe janë dhënë Parimet dhe Orari për aplikimin nga KEK SH.A dhe KOSTT SH.A për tarifat e vitit 2008. Njoftimi është publikuar në ueb-faqen e ZRRE-së.

ZRRE-ja gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit të tarifave i ka dhënë rëndësi të veçantë pjesëmarrjes së publikut dhe marrjes në konsideratë të komenteve.. Në këtë proces është përfshirë: publikimi i dokumenteve kyçe në ueb-faqe, mbajtja e mbledhjeve publike, diskutimet e drejtpërdrejta me palët e interesit, me të licencuarit, përfaqësuesit e qeverisë dhe të parlamentit, si dhe konsumatorët.

3.6.4 REZULTATET E APLIKIMIT TË TARIFAVE TË REJA DHE NDRYSHIMET ME ATO EKZISTUESE

Shqyrtimi i aplikacionit të reviduar të KEK SH.A. nga ana e ZRRE-së, ka konstatuar se tarifat e propozuara janë në pajtueshmëri me të ardhurat e lejuara të reviduara, por struktura e propozuar nuk është në pajtueshmëri të plotë me parimet e vendosura në procesin e shqyrtimit, prandaj ka prezantuar draftin final të saj për të cilën KEK SH.A nuk ka pas kundërshtime pas argumenteve të prezantuara nga ZRRE-ja.

Vendosja e tarifës së mbijetesës

Të ardhurat e lejuara kanë qenë bazë për aplikimin e KEK SH.A dhe KOSTT SH.A për tarifa të reja. Natyrisht KEK SH.A në bazë të legjislacionit i jepet liria për dizajnimin e tarifës dhe cilindo dizajn që e prezanton nuk guxon të tejkalojë shumën e të hyrave të lejuara.

Procesi i reformës tarifore ka marrë parasysh edhe konsumatorët me të hyra të ulëta, e kjo është bërë me vendosjen e “bllok tarifës” (“tarifa e mbijetesës”). Tri blloqet e aprovuara të konsumit janë:

<200kWh/muaj – paraqet përlllogaritjen e ZRRE-së për nevojat minimale të energjisë elektrike për konsumatorët të cilët nuk shfrytëzojnë energjinë elektrike për ngrohje, këta ngarkohen me tarifën më të ulët prej 70% të mesatares së tarifës së konsumatorëve shtëpiakë

201-600kWh/muaj – paraqet përlllogaritjen e ZRRE-së për nevojat e arsyeshme të konsumatorëve për energji elektrike të cilët shfrytëzojnë

² Rregullatori në procesin e rishikimit të tarifës vetëm ka aplikuar të drejtën e operatorëve për të hyra të reviduara duke mos ndryshuar dhe cenuar vendimin e marre me 15 mars 2007.

energjinë elektrike për ngrohje, këta ngarkohen me 90% të mesatares së tarifës së konsumatorëve shtëpiakë.

>600/kWh/muaj – ngarkohen me tarifën më të lartë për të mbuluar çfarëdo mungese në të hyra, ndërmjet atyre të mbuluara sipas tarifave mesatare për konsumatorët shtëpiak me pakicë dhe atyre të mbuluara sipas dy blloqeve të para.

Tab. 3.10 . Përqindjet e konsumit dhe konsumi i energjisë sipas niveleve të konsumit (bllok tarifave)

Konsumatorët Shtëpiak 0.4 kV	Njehsori dytarifor (000)€	Njehsori njëtarifor (000)€	Pa njehsor (000)€	Konsumi sipas blloqeve (%)	Konsumi sipas blloqeve MWh
Blloku i parë	14110	2354	1144	34	490693
Blloku i dytë	20999	3453	2607	39	560980
Blloku i tretë	20452	3316	348	27	385886
Total	55561	9303	4099	100	1437559

Subvencionet e dhëna nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për KEK SH.A për vitin 2007 janë si vijon:

- Për blerjen e energjisë elektrike (import) për vitin 2007 janë dhënë 12.9 milion euro;
- Për rastet me asistencë sociale për vitin 2007 janë dhënë 4,5 milion euro;
- Humbjet jo-teknike të lejuara për vitin 2007 janë 21%;

Caku kryesor - zvogëlimi i humbjeve jo-teknike është i lidhur edhe me rregullat tjera të miratuara tani më nga ZRRE-ja si p.sh: Rregulli i Kushteve të Përgjithshme për Furnizim me Energji, Rregulli mbi Shkycjet e Konsumatorëve, Rregulli mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve etj, e që në rast zbatimi korrekt medoemos do të zvogëlonin këto humbje.

Rezultatet

Tarifat e reja janë të zbatueshme prej 1 majit 2007 dhe tarifat mesatare për konsumatorët shtëpiak dhe për konsumatorët në tërësi janë të nivelit të njëjtë me tarifat e vjetra por kanë një strukturë të re në krahasim me ato të zbatuara deri më 1 Maj 2007 dhe ato janë të paraqitura në vijim :

Tab. 3.11 Tarifa me pakicë të miratuar nga ZRRE-ja dhe të zbatueshme nga K SH.A prej 1 maj 2007

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Aprovuar	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34,00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		519,00	519,00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6,03	1,78
			€/kWh	Tarifa e ulët	2,50	1,47
1	35kV	Energjia reaktive (Q)	€/kVArh			
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		30,00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		540,00	540,00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6,30	2,73
2	10kV		€/kWh	Tarifa e ulët	3,33	2,47
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0,04	0,04
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34,00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		466,00	466,00
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët me shpenzim të energjisë)	Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7,07	3,15
			€/kWh	Tarifa e ulët	3,81	2,87
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0,32	0,32
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		29,00	
4	0.4kV Kategoria II	Fuqia e angazhuar	€/kW		270,00	270,00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7,85	4,36
			€/kWh	Tarifa e ulët	4,95	4,11
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		1,53	1,53
5	0.4kV matësi 2-tarifor (2-vlerësh) shtëpiak c)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34,00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW			
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	9,68	6,26
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	11,64	7,63
			€/kWh	Tarifa e ulët	5,82	3,81
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24,00	
		Energjia aktive (P), për konsum:				
		<200 kWh/muaj (Biloku i parë)	€/kW		0,00	0,00
		200-600 kWh/muaj (Biloku i dytë)	€/kW		0,00	0,00
		>600 kWh/muaj (Biloku i tretë)	€/kW		0,00	0,00
6	0.4kV matësi 1-tarifor (1-vlerësh) shtëpiak c)	Energjia aktive (P), për konsum:				
		<200kWh/muaj (Biloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	4,42	3,17
			€/kWh	Tarifa e ulët	2,21	1,58
		200-600 kWh/muaj (Biloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	5,97	4,28
			€/kWh	Tarifa e ulët	2,99	2,14
		>600 kWh/muaj (Biloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	8,67	6,21
			€/kWh	Tarifa e ulët	4,33	3,11
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24,00	
		Energjia aktive (P), për konsum:				
		<200 kWh/muaj (Biloku i parë)	€/kW		0,00	0,00
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	200-600 kWh/muaj (Biloku i dytë)	€/kW		0,00	0,00
		>600 kWh/muaj (Biloku i tretë)	€/kW		0,00	0,00
		Energjia aktive (P), për konsum:				
		<200kWh/muaj (Biloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e vetme	3,94	2,82
8	Ndriqimi publik	200-600 kWh/muaj (Biloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e vetme	5,32	3,81
		>600 kWh/muaj (Biloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e vetme	7,72	5,53
		Konsumi i vlerësuar <400kWh/muaj	€/konsumator/muaj		20,00	
8	Ndriqimi publik	Konsumi i vlerësuar 400-800kWh/muaj	€/konsumator/muaj		36,00	
		Konsumi i vlerësuar >800kWh/muaj	€/konsumator/muaj		61,00	
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34,00	
8	Ndriqimi publik	>600 kWh/muaj (Biloku i tretë)	€/kWh	Tarifa e vetme	7,82	7,82

- a Tarifa e lartë aplikohet prej 07:00-22:00 gjatë sezonës së dimrit dhe prej 08:00-23:00 gjatë sezonës së verës;
- b Konsumatorët e regjistruar si raste sociale ngarkohen me normë zero deri në nivelin e lejuar nga qeveria
- c Konsumatori ngarkohet me energji reaktive të shpenzuar mbi atë të lejuar, $\cos \varphi = 0.95$

Tab. 3. 12 Tarifat e KOSTT SH.A të zbatueshme prej 1 maj 2007

Tarifat	Njësia	Tarifat e miratuara
Tarifa për rrjete		
400/200 kV	EUR/kW/vit ^a	3.025
110 kV	EUR/kW/vit ^b	6.792
Tarifa për operim të sistemit	EURc/MWh	0.849
Tarifa për operim të tregut	EURc/MWh	0.014

a Aplikohet për mesataren e nevojës në kohën e pesë nevojave më të larta maksimale të sistemit në vit. Vetëm furnizuesve ju lejohet kjo ngarkesë.

b Përfshin ngarkesën prej 400/220 kV

3.7 SEKTORI I GAZIT NË KOSOVË

Në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nr. 2004/9, Kreu 3, Neni 15, kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji, shtrihen edhe në sektorin e gazit. Dokumenti Strategjia e Energjisë së Kosovës për periudhën 2005 – 2015 parasheh që Kosova si burim të energjisë të ketë edhe gazin. Është i njohur fakti se Kosova nuk ka burime të gazit, por pritet që gazi do të jetë prezent në Kosovë si rezultat i investimeve rajonale në linja gaz-sjellëse që ndërlidhin burimet e gazit në rajonin Kaspik dhe atë rus drejt shteteve të perëndimit. Se cilat linja të gazit do ta përshkojnë Kosovën, do të varet nga zhvillimet rajonale, me ndikim të interesave gjeo-politike në të.




Fig. 3.12 Rugët perspektive të gypave gaz-sjellës

Burim i dokumentit: "Base map: GIE; routes: public announcements and press releases." (Harta bazike: GIE; linjat: njoftimet publike dhe për media)

ZRRE-ja duke pasur parasysh përgjegjësitë e saj në çështje të zhvillimit (përgatitjes) të kornizës rregullative për gaz ka marrë pjesë aktive në takime pune rajonale për çështje të gazit. Kështu gjatë vitit 2007 ka marrë pjesë në takimet e Grupit të Punës për Gaz,

organ i Traktatit të Energjisë së Evropës Juglindore, dhe ka kontribuar në finalizimin e dokumentit „Raport Analitik i Gazit, Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë, Grupi Punues i Gazit”, 24 shtator 2007 (ECRB South East Europe-Gas Survey Gas Working Group-draft), pastaj dokumenti “Rregullativa për Investimin në Infrastrukturën e Re të Gazit, Komuniteti i Energjisë së EJT 2006-2007 (“New Gas Infrastructure Investment Regulation”), etj.



Fig. 3.13 Koncept i Komunitetit të Energjisë i unazës së gazit ne kontekst rajonal

Burimi i dokumentit: “Base map from WinGas GmbH. © Verlag Gluckhauf GmbH, Essen 2006, with Energy Community gas transmission ring pipeline indicative route overlay by ECA.”
– (Harta Bazë nga WinGas GmbH. © Verlag Gluckhauf GmbH, Essen 2006, bashkë me linjat indicative të unazës së bartjeit nga ECA)

Gjatë vitit 2007 ka përfunduar edhe studimi për nevoja të Traktatit të Energjisë Juglindore me titull “Studimi i gazifikimit të Evropës Juglindore”, Raport nr. 17102007. Ky studim është kryer nga konsulencia britanike dhe është financuar nga Banka Botërore dhe Banka Gjermane KfW. Qëllimi i studimit ka qenë identifikimi i infrastrukturës ndërkufitare të gazit që do të ishte fisibël dhe ekonomik, si dhe aspektet financiare, etj. Studimi gjithashtu analizon dhe bënë propozime për ngritje legjislativë dhe institucionale të problematikës së lidhur me financim dhe implementim të projekteve infrastrukturore të gazit. Studimi analizon furnizimin me gaz nga burimet Ruse, Kaspikë, si dhe nga burimet të tjera perspektive, duke pranuar që gypat gazsjellës do të kalojnë nëpër Turqi dhe shtete të tjera tranzite (duke përfshirë edhe LNG – gazin natyror të lëngshëm). Ai vlerëson kostot e furnizimit dhe gazifikimit perspektiv në nëntë tregje të gazit në Evropën Juglindore: Shqipëria, Bosnia and Hercegovina, Bulgaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia. Hartuesit e studimit kanë bërë edhe vizita në Kosovë, duke kontaktuar zyrtarët e MEM-it dhe të ZRRE-së.

Si faktor kufizues në Kosovë i zhvillimit të kornizës rregullative për gaz ka qenë dhe mbetet edhe mëtutje mungesa e ligjit për gaz. Si detyrë urgjente për Kosovën është nxjerrja e këtij ligji, gjë që do të mundësonte ndërtimin e kornizës rregullative për gaz. Të gjitha dokumentet e prodhuara nga grupi i gazit, raportet dhe studimet të Traktatit të Komunitetit për Energji të Europës Jug-Lindore mund të gjinden ne ueb-faqen e sekretariatit: www.energy-community.org.

3.8 SEKTORI I NGROHJES QENDRORE

3.8.1 PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E NGROHJES QENDRORE

Ngjashëm si në vitet e fundit, sektori i ngrohjes qendrore në Kosovë nuk ka shënuar ndonjë zgjerim të dukshëm dhe mbetet mjaft i vogël në krahasim me kërkesën e parashikuar për ngrohje në Kosovë, duke mbuluar kështu rreth 5% të kërkesës totale për ngrohje. Sektori është i kufizuar vetëm në katër kompani/ndërmarrje të ngrohjes qendrore të cilat mbulojnë Komunitetin e Prishtinës, Gjakovës, Mitrovicës dhe Zveçanit, asetet e të cilave janë nën përkujdesje dhe administrimin e AKM-së.

Viti 2007 ishte viti i dytë i funksionimit të kompanive të ngrohjes qendrore (KNQ) Termokos dhe Gjakova si korporata, pas përfundimit të procesit të korporatizimit /transformimit në shoqëri aksionare në fund të vitit 2005. Këto dy kompani ende janë në proces të implementimit të qeverisjes korporative dhe të realizimit të objektivave për funksionim të suksesshëm në baza komerciale. Me gjithë zhvillimet pozitive në këtë drejtim, këto kompani ende nuk funksionojnë si biznese të vetë-qëndrueshme dhe profitabile, dhe për pasojë mbesin ende të varura nga subvencionet e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Ndryshe nga KNQ-të Termokos dhe Gjakova, ndërmarrjet e ngrohjes qendrore (NNQ) Termomit dhe Zveçan, mbesin ende nën ndërmarrjet e integruara komunale në Mitrovicë respektivisht Zveçan.

3.8.2 PERFORMANCA E KOMPANIVE TË NGROHJES QENDRORE

Sektori i ngrohjes qendrore në Kosovë ka katër sisteme të ngrohjes qendrore në: Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan, të cilat kryesisht furnizojnë me ngrohje zonat urbane të komunave në fjalë.

■ Konsumi i lëndëve djegëse dhe gjenerimi i ngrohjes

Gjenerimi i ngrohjes bëhet në ngrohoret qendrore të pajisura me kaldaja, të cilat kryesisht përdorin mazut dhe në një masë të vogël përdorin naftë (dizel), e të cilat importohen me çmime të bursës plus një “premium” për mbulimin e shpenzimeve të furnizuesit.

Më poshtë është paraqitur sasia e konsumit të lëndëve djegëse dhe çmimet e blerjes së tyre gjatë periudhës së ngrohjes 2006/2007, sipas të dhënave të raportuara nga KNQ-të.

Tab. 3.13: Konsumi i derivateve dhe çmimi mesatar blerës për sezonin 2006/2007

Kompania -Sistemi i NQ-së	Mazuti		Nafta (Dizeli)	
	Kons.(ton)	Çmimi mesatar blerës - TVSH e përfshirë(€/ton)	Kons.(litër)	Çmimi mesatar blerës - TVSH e përfshirë(€/litër)
TERMOKOS - Prishtina	11,910.67	294.09	NA	NA
NQ GJAKOVA	1,612.12	293.6	NA	NA
TERMOMIT - Mirovica	NA	NA	NA	NA
NQ ZVEÇAN	NA	NA	NA	NA
Totali i Sektorit të NQ-ve	13,522.79	NA	NA	NA

NA – Nuk aplikohet (ose nuk është në dispozicion)

Pajisjet për gjenerimin e ngrohjes të KNQ Termokosit përbëhen nga ngrohtorja kryesore me kapacitet 120MW – dy kaldaja me mazut me kapacitet 58MW secila, kaldaja për furnizim vetanak me kapacitet prej 4MW, si dhe kapaciteti rezervë – një kaldajë me mazut 29MW (nuk është në funksion). Ngrohtorja ndihmëse në Qendrën spitalore universitare përbëhet nga dy kaldaja me naftë me kapacitetin e tërësishëm prej 14MW – secila kaldajë ka kapacitetin 7MW.

Ngrohtorja e KNQ Gjakova ka dy kaldaja me mazut ku njëra ka kapacitet 20 MW ndërsa tjetra 18.6 MW, e që japin kapacitetin e tërësishëm prej 38.6 MW. Kaldaja me kapacitet 18.6MW është jashtë funksionit.

Kapacitetet gjeneruese të NNQ Termomit, Mitrovicë përfshijnë: ngrohtoren kryesore të pajisur me vetëm një kaldajë funksionale me kapacitet nominal 9.3MW, dhe ngrohtoren në qendrën spitalore që posedon tri kaldaja të vogla me kapacitet të përgjithshëm 7.6MW.

Në NNQ Zveçan gjenerimi i ngrohjes mundësohet nga ngrohtorja me kapacitet të përgjithshëm 1.6MW – dy kaldaja me naftë (dizel) nga 800kW.

Shpërndarja e ngrohjes

Karakteristikë e përbashkët e të gjithë sistemeve të ngrohjes qendrore në Kosovë, është se rrjeti i tyre i shpërndarjes përbëhet nga rrjeti primar që shtrihet deri në pikën e furnizimit në nënstacione, dhe nga rrjeti sekondar i cili shtrihet nga pika e furnizimit në nënstacione gjer tek shfrytëzuesit përfundimtarë.

Rrjeti i shpërndarjes të ngrohjes i KNQ Termokosit ka një gjatësi prej afërsisht 29 km, me kapacitet rreth 300 MW gjë që nënkupton se rrejt i shpërndarjes është i mbi-dimensionuar. Pjesë integrale e rrjetit të shpërndarjes është edhe stacioni i pompimit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë i cili gjendet në Bregun e Diellit dhe 250 nënstacione të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar.

Rrjeti i shpërndarjes i KNQ Gjakova shtrihen në gjatësi prej 16km, 4km nga të cilat janë gypa të ndërtuar rishtazi në vitin 2001, dhe afërsisht 4km zgjerim të rrjetit në vitet 2006 dhe 2007. Pjesë përbërëse e këtij rrjeti janë edhe rreth 160 nënstacione të cilat janë

pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar. Njehsorët e konsumit të ngrohjes janë instaluar në 42 nën-stacione.

Sistemi i ngrohjes qendrore në Mitrovicë përmban praktikisht dy rrjete të ndara të shpërndarjes. Pjesa kryesore e rrjetit është e lidhur me ngrohtoren kryesore, përderisa pjesa tjetër është e lidhur me ngrohtoren në qendrën spitalore. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të shpërndarjes është rreth 4.5km. Ekzistojnë afërsisht 20 nën-stacione të furnizimit me ngrohje, prej të cilave asnjëra nuk është e pajisur me njehsor.

Sistemi i ngrohjes qendrore në Zveçan ka një rrjet shpërndarjeje mjaft të vogël me gjatësi të përgjithshme prej 0.8km.

Një përmbledhje e karakteristikave teknik të sistemeve të ngrohjes qendrore, si dhe e të dhënave të gjenerimit dhe furnizimit paraqiten ne tabelën më poshtë.

Tab. 3.14: Karakteristikat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

Kompania(Vendi)	Kapaciteti I instaluar [MW]	Kapaciteti Operacional[MW]	Rrjeti i Shpërndarjes		Gjenerimi i ngrohjes. [MWh/vit]	Furnizimi me ngrohje në nën-stacione të konsumatorëve [MWh/vit]
			Gjatesia e rrjetit [km]	Nr. i nënst.		
TERMOKOS - (Prishtinë)	2 x 58 = 116	2 x 58 = 116				
	1 x 29 = 29	2 x 7 = 14	29	250	122,058	91,430
	2 x 7 = 14	1 x 4 = 4				
	1 x 4 = 4					
Nën-total	163	134	29	250	122,058	91,430
NQ GJAKOVA	1 x 20 = 20	1 x 20 = 20	16	160	18,217	10,937
	1 x 18.6 = 18.6					
Nën-total	38.6	20	16	160	18,217	10,937
TERMOMIT(Mitrovicë)	1 x 9.3 = 9.3	1 x 9.3 = 9.3				
	2 x 3.3 = 6.6	2 x 3.3 = 6.6	4.5	20	NA	NA
	1 x 1.0 = 1.0	1 x 1.0 = 1.0				
Nën-total	16.9	16.9	4.5	20	NA	NA
NQ ZVEÇAN	2 x 0.8 = 1.6	2 x 0.8 = 1.6	0.8	NA	NA	NA
Nën-total	1.6	1.6	0.8	NA	NA	NA
Total	220.1	172.5	50.3	430	140,275	102,367

NA – Nuk aplikohet (ose nuk është në dispozicion)

■ Çështje lidhur me konsumatorët

Shërbimi i furnizimit

Sipërfaqja aktuale e shërbimit të furnizimit me ngrohje e mbuluar nga Termokos-i, për të dy grupet e konsumatorëve është rreth 1,008,915m² – proporcioni ndërmjet grupit të konsumatorëve shtëpiakë dhe atij komercial e institucional është 62%-38%. Termokosi në përgjithësi furnizon përafërsisht 12,100 konsumatorë: 11,540 amvisëri dhe 560 konsumatorë komercialë e institucionalë.

Sipërfaqja totale e vlerësuar e shërbimit të furnizimit me ngrohje e NQ Gjakova është rreth 127,700 m², ku bëjnë pjesë konsumatorët shtëpiakë dhe ata komercialë e institucionalë me proporcion i cili është përafërsisht 48% - 52 %.

Termomit-i me shërbimin e furnizimit me ngrohje i përfshin të dy grupet e konsumatorëve, shtëpiak dhe konsumatorët komercial e institucional. Për shkak

kushteve të këqija të rrjetit dhe sistemeve sekondare, konsumatorët shtëpiakë, këto vitet e fundit nuk janë furnizuar me ngrohje. Sipërfaqja e furnizimit me ngrohje e konsumatorëve komercialë e institucionalë vlerësohet të jetë rreth 27,100 m².

Sipërfaqja e furnizimit me ngrohje e Zveçanit përfshin vetëm grupin e konsumatorëve komercial e institucional, e cila vlerësohet të jetë afërsisht 8,900 m².

Faturimi dhe Arkëtimi

Progresi në drejtim të realizimit të objektivave të lidhura me faturimin efikas dhe rritjen e arkëtimit paraqet problemin më madhorë, që edhe në 2007 nuk shënon përmirësim të dukshëm nga viti paraprak.

Faturimi ende kryhet sipas sipërfaqes së para-vlerësuar ngrohëse të secilit konsumatorë (për metër katrorë) për shkak të mungesës së implementimit të njehsimit (matjes) të ngrohjes së furnizuar. Sa i përket faturimit janë vërejtur vështirësi në kuptim të mos arritjes së nivelit të planifikuar të faturimit për shkak të zbritjes në fatura të ditëve pa ngrohje të shkaktuara nga prishjet e sistemit (ngrohtorja, rrejt) dhe mungesa e lendes djegëse, si dhe për shkak të ngrohjes së pamjaftueshme si pasojë e rrjedhjeve të ujit të ngrohtë në sistemin e shpërndarjes. Ndikim në mos arritjen e nivelit adekuat të faturimit ka edhe mos azhurnimi dhe saktësia e pamjaftueshme e bazës së të dhënave të konsumatorëve.

Shkalla mesatare e arkëtimit të pagesave për sektorin e ngrohjes qendrore vlerësohet të jetë ende e ulët, rreth 39.5% për sezonin 2006/2007, e cila megjithatë paraqet një rritje për 4.5% në krahasim me sezonin 2005/2006.

Tab. 3.15 Shkalla e arkëtimit në kompanitë e NQ-ve në Kosovë për sezonin 2006/'07

Sezoni i ngrohjes 2006/2007	Sip. ngrohëse [m ²]	Tarifa [€/m ²]	Faturimi (përf. TVSH) [€]	Arkëtimi [€]	Shkalla e arkëtimit [%]
NQTermokos Prishtina					
Amvisëri	630,083	0.79	2,775,666	532,937	19.2
Komercial e Institut.	387,832	0.95	2,235,670	1,337,201	59.8
Total	1,008,915		5,011,336	1,870,138	37.3
NQ Gjakova					
Amvisëri	61,400	0.87	315,601	68,996	21.9
Komercial e Institut.	66,300	1.26	502,217	277,925	55.3
Total	127,700	-	817,818	346,921	42.4
NQTermomit Mitrovica					
Amvisëri	0	NA	NA	NA	NA
Komercial e Instituc.	27,100	1.3	NA	NA	NA
Total	27,100		NA	NA	NA
NQ Zvecan					
Amvisëri	0	NA	NA	NA	
Komercial e Instituc.	8,889	1.23	NA	NA	NA
Total	8,889		NA	NA	NA

NA – Nuk aplikohet (ose nuk është në dispozicion)

Arkëtimi i ulët i pagesave është i shkaktuar nga një varg faktorësh të ndryshëm. Disa nga këta faktorë janë drejtpërdrejtë të lidhur me kompanitë e ngrohjes qendrore siç

janë: performanca jo e kënaqshme e gjenerimit dhe furnizimit, shërbimi i dobët ndaj konsumatorëve dhe jo efikasiteti në faturim dhe arkëtim.

Faktorët tjerë të lidhur me situatën e përgjithshme ekonomike dhe të ardhurave të popullsisë janë mundësia dhe vullneti për të paguar, mungesa e administrimit banesorë dhe masat e pamjaftueshme ligjore për trajtimin e çështjes së mos pagesës nga konsumatorët. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për sipërfaqet ngrohëse, tarifave, faturimin dhe arkëtimin për kompanitë respektive të ngrohjes qendrore.

3.8.3 SHQYRTIMI I ÇMIMEVE TË NGROHJES QENDRORE PËR SEZONIN E NGROHJES 2007/2008

■ Korniza ligjore dhe rregullative për shqyrtimin e çmimeve të ngrohjes qendrore

Në pajtim me legjislacionin primar, nenet 46, 47, 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja ka autoritet për krijimin e metodologjisë tarifore dhe miratimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë.

Këtu jepen një sërë parimesh të gjëra si parimet e arsyeshmërisë, dhe jo diskriminimit sipas të cilave ndërmarrjet energjetike duhet t'i rikthejnë të gjitha kostot e arsyetuara përfshirë këtu edhe kthimin e arsyeshëm në investimet e tyre.

Sektori i ngrohjes qendrore në Kosovë në transportimin dhe në shpërndarjen e ngrohjes klasifikohet si monopol natyror, përderisa në gjenerimin e ngrohjes dhe furnizimin e ngrohjes ende nuk ekziston ndonjë konkurrencë. Prandaj tarifave e ngrohjes qendrore i nënshtrohen miratimit nga ZRRE-ja.

Në përputhje me obligimet ligjore dhe kompetencat e saja, ZRRE-ja më 11 qershor 2007 shpalli fillimin e shqyrtimit të çmimeve të ngrohjes qendrore për sezonin e ngrohjes 2007/2008, duke pasur qëllim kryesor vlerësimin real të informatave financiare dhe teknike të dorëzuar nga KNQ-të, në mënyrë që tarifave e ngrohjes qendrore të reflektojnë kostot reale.

Në lidhje me këtë ZRRE-ja ka nxjerrë dy udhëzime:

- Udhëzimi i Përkohshëm I_04_2007 për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrhjes Qendrore
- Udhëzimi i Përkohshëm I_05_2007 për Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrhjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrhjes 2007/2008.

Metodologjia Tarifore

Për formulimin/llogaritjen e tarifave dhe çmimeve është zbatuar metodologjia e Normës së kthimit (RoR) ose e ashtuquajtura kosto plus.

Metodologjia RoR definon koston e lejuar e cila duhet të rikthehet dhe profitin e arsyeshëm i cili duhet të fitohet nga KNQ-ja, i cili profit është llogaritur sipas Normës së lejuar të kthimit (RoR) mbi Bazën e rregulluar të aseteve (RAB).

Skematikisht, metodologjia RoR mund të tregohet si më poshtë:




Fig. 3.14 Skema e llogaritjes së të ardhurave të lejuara sipas metodologjisë RoR
 * ΔWC: Ndryshimi në kapitalin punues

■ Procesi i shqyrtimit të çmimeve

ZRRE-ja filloi me kohë përparësi, përmes nxjerrjes dhe publikimit të udhëzimeve dhe dokumenteve tjera relevante. Për më tepër janë mbajtur takime informuese dhe janë bërë ndërveprime tjera me KNQ-të dhe palët e interesuara të involvuara në sektorin e ngrohjes qendrore, me qëllim që të shpjegohen dhe sqarohen udhëzimet dhe aspektet kryesore të procesit të shqyrtimit të çmimeve.

Në përputhje me procedurat të parapara në udhëzimet e lartpërmendura, procesi i shqyrtimit të çmimeve filloi me dorëzimin në ZRRE të raporteve rregullative e pasuar me aplikacionin për tarifa nga kompanitë e ngrohjes qendrore. Duhet të theksohet, se ashtu si viteve të kaluara, raportimi rregullativ dhe aplikacionet për tarifa të dorëzuara nga KNQ-të Termokos dhe Gjakova kishin mangësi, ndërsa NNQ Termomit – Mitrovicë dhe NNQ Zveçan nuk ka dorëzuar raportin rregullativ dhe aplikacionin për tarifa.

Procesi i shqyrtimit të çmimeve për sezonin 2007/'08 ka përfshirë këto faza kryesore:

- Bashkërendimin e të ardhurave të lejuara i bazuar në ndryshimin e të ardhurave të projektuara për sezonin paraprak të ngrohjes (2006/2007) dhe aktualisht të realizuara në këtë sezon;
- Përcaktimin e të ardhurave të lejuara në bazë të informatave dhe të dhënave të parashikuara të dorëzuara me aplikacionin për tarifa për sezonin e ngrohjes 2007/'08;
- Llogaritjen e tarifave bazuar në të ardhurat e lejuara dhe propozimin për tarifa të cilat iu nënshtruan miratimit përfundimtar nga ZRRE-ja.

Si rrjedhojë e fazave të lartpërmendura, ZRRE-ja nxori këto dokumente:

- Bashkërendimin për KNQ-të Termokos dhe Gjakova, të shoqëruara me raporte rregullative gjithëpërfshirëse për secilën KNQ të cilat janë dhënë si shtojca të përcaktimit të bashkërendimit;
- Vendimet për miratimin e të ardhurave të lejuara për KNQ Termokos dhe KNQ Gjakova, të shoqëruar me raport rregullativ gjithëpërfshirës e të hollësishëm në formë të shtojcës respektive të vendimit për të ardhurat e lejuara.
Përcaktimi i të ardhurave të lejuara kryesisht ka përfshirë:
 - Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove të lejuara operacionale;
 - Vlerësimin dhe përcaktimin e shkallës së zhvlerësimit;
 - Përcaktimin e kthimit të lejuar në RAB, ku përfshihen: i) përcaktimi i RAB-it; dhe ii llogaritja e “WACC-ut” dhe profitit të lejuar;
 - Bashkërendimin që është bazuar në diferencën ndërmjet të ardhurave të projektuara dhe aktuale të sezonit paraprak.

Duhet të theksohet se përcaktimi i të ardhurave të lejuara ka qenë bazë e llogaritjes përfundimtare të tarifave dhe dorëzimit të propozimit për tarifa nga kompanitë e ngrohjes qendrore, për miratim final nga ZRRE-ja.

Vendimet e ZRRE-së për miratimin e normave tarifore të shoqëruara me shtojcat përkatëse shënojnë përfundimin e procesit të shqyrtimit të çmimeve të ngrohjes qendrore për sezonin 2007/2008.

Tab. 3.16a Përmbledhje e tarifave për kompanitë e ngrohjes qendrore në Kosovë – sezoni i ngrohjes 2007/2008

A.TARIFAT E NGROHJES PËR KONSUMATORËT PA MATUR			
KOMPANITË NQ	Komponentët e tarifave	Amvisëri m² në muaj	Komercial dhe institucional për m² në muaj
NQ TERMOKOS SH.A	Kapaciteti ngrohës i kontraktuar(komp. fikse)	€ 0.11	€ 0.13
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	€ 0.68	€ 0.82
NQ GJAKOVA SHA	Kapaciteti ngrohës i kontraktuar(komp. fikse)	€ 0.18	€ 0.22
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	€ 0.67	€ 1.01
NPK STANDARD / NJNQ TERMOMIT	Kapaciteti ngrohës i kontraktuar(komp. fikse)	NA	€ 0.25
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	NA	€ 1.05
NPK ZVEÇAN	Kapaciteti ngrohës i kontraktuar(komp. fikse)	NA	€ 0.10
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	NA	€ 1.13

B.TARIFAT E NGROHJES PËR KONSUMATORËT E MATUR		
KOMPANITË NQ	Komponentët e tarifave	Për njësi matëse
NQ TERMOKOS SH.A	Kapaciteti ngrohës i kontraktuar (komp. fikse)	€ 1.09 / kW për muaj
	Ngrohja e furnizuar (komponenta variabël)	€ 41.00 / MWh
NQ GJAKOVA SHA	Kapaciteti ngrohës i kontraktuar(komp. fikse)	€ 1.80 / kW për muaj
	Ngrohja e furnizuar (komponenta variabël)	€ 45.89 /kW për muaj
NPK STANDARD / NJNQ TERMOMIT	Kapaciteti ngrohës i kontraktuar(komp. fikse)	NA
	Ngrohja e furnizuar (komponenta variabël)	NA
NPK ZVEÇAN	Kapaciteti ngrohës i kontraktuar(komp. fikse)	NA
	Ngrohja e furnizuar (komponenta variabël)	NA

NA–Nuk është e aplikueshme

Në Tab.3.16, janë janë paraqitur tarifat e ngrohjes qendrore për sezonin e ngrohjes 2007/2008, për secilën KNQ/NNQ.

Si u përmend më lartë, NNQ Termomit, Mitrovicë dhe NNQ Zveçan kanë dështuar të dorëzojnë aplikacionin për tarifa për sezonin 2007/2008. ZRRE-ja ka konsideruar se, në mungesë të aplikacionit dhe duke marrë parasysh rrethanat objektive të njohura, aplikohen të njëjtat tarifa siç janë aprovuar nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2006/2007

Përcjellja e implementimit të tarifave për sezonin 2007/2008

Në vazhdimësi, ZRRE-ja monitoron për së afërmi implementimin e tarifave përmes kontakteve dhe mbledhjeve të rregullta me KNQ-të. Aspektet kryesore të monitorimit janë: realizimi i faturimit të planifikuar, arkëtimi i pagesave të konsumatorëve, ndikimi e tarifave në shkallën e arkëtimit, si dhe sasia dhe cilësia e ngrohjes së furnizuar.

ZRRE-ja vazhdimisht inkurajon KNQ-të të kalojnë nga “tarifa normative” në “tarifën e energjisë së konsumuar” sa më shumë që është e mundur, duke potencuar se “tarifa e energjisë së konsumuar” e bazuar në konsumin real të matur të ngrohjes është në favor të nxitjes së konsumatorëve për ruajtjen e ngrohjes dhe përdorimit sipas nevojave të tyre, si dhe të faturimit real, d.m.th. konsumatorit i faturohet vetëm energjia e cila është konsumuar, gjë e cila mund të rris shkallën e arkëtimit. Për më tepër implementimi i “tarifës së energjisë së konsumuar” do të jetë një kërkesë ligjore që del nga Ligji për Ngrahjen qendrore, i cili është në pritje të shpalljes zyrtare.

3.9 AKTIVITETET RRETH ZHVILLIMIT TË MËTUTJESHËM TË PROJEKTIT KOSOVA-C

“Projekti Asistenca Teknike Energjia nga Linjiti” (shkurte PATEL) i përkrahur nga Banka Botërore, dhe nën udhëheqjen e Komitetit Drejtues të Projektit (KDP), dhe i kryesuar nga ministri i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave ka vazhduar aktivitetet gjatë vitit 2007 në përmbushjen e synimeve të projektit të cilat janë:

- Të ndihmojë IPVQ-të të përforcojnë kornizat politike, ligjore dhe rregullative të favorshme për investime të reja në sektorin e energjisë; zhvillimin e instrumenteve të ndryshme politike, ligjore dhe rregullave në energjetikë në harmoni me praktikën e mira ndërkombëtare dhe zhvillimin e asistencës teknike për organizimin e ofertimit dhe negociimeve të cilat rezultojnë me përmbyllje financiare të investimeve;
- Të ndihmojë IPVQ-të në një pilot transaksion për joshjen e investimeve private për ndërtimin e kapaciteteve të reja për gjenerim të energjisë elektrike me linjit, të udhëhequra nga parimet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale;

Detaje rreth organizimit dhe funksionimit të zyrës së projektit dhe aktiviteteve të ndërmarra më herët, janë të prezantuar në Raportin Vjetor të ZRRE-së të vitit 2006. Përfaqësuesit

e ZRRE-së kanë marrë pjesë rregullisht në takimet e organizuara gjatë vitit 2007 të KDP, dhe kanë dhënë komente të vyeshme në të gjitha zhvillimet e lidhura me projekt.

Gjatë vitit 2007 Zyra e projektit ka ndërmarrë një varg aktivitete, në pajtim me diagramin kohor të zhvillimit të projektit siç janë: prokurimi i shërbimeve të konsulencës për transaksione, konsulencës ligjore dhe rregullative, konsulencës për mjedis dhe çështje sociale, gjithashtu kanë vazhduar aktivitete për themelimin dhe aftësimin e zyrës së projektit, për të dhënë informacione dhe shënime që janë të rëndësishme për zhvillim të projektit.

Konsulenca e projektit, gjatë vitit 2007, ka ndihmuar KDP të PATEL në radhë të parë duke bërë:

- Shqyrtimin e strukturës së tregut, strukturës ligjore dhe mjedisore, duke propozuar masa për të lehtësuar apo mundësuar kryerjen e transaksionit;
- Përgatitja e modelit financiar investiv të bazuar në analizën opcionale dhe dhënien e rekomandimit në lidhje me listën e shkurtër të ofertuesve të kualifikuar.




Fig. 3 15 Roli i Konsulencës në zhvillim të projektit

Këshilltarët e projektit gjatë vitit 2007 kanë përgatitur dokumentet: Draft Raporti Diagnostifikues Fillestar; studimin për mjedisin dhe çështje sociale, etj. Në këto dokumente përshkruhet gjendja ekzistuese në sferën e legjislacionit, të tregut, rregullimit, çështjeve sociale dhe të mjedisit.

KDP-ja gjatë vitit 2007 ka miratuar disa dokumente, siç janë: Manuali i Punës, Kodi i Sjelljes dhe Kodi i Etikës, etj. Në manualin e punës së projektit paraqiten parimet, procedurat dhe rregullat për implementimin e asistencës teknike për energji nga linjiti, duke shtruar bazën dhe duke përdorur lidhje me një varg dokumentesh tjera parësore siç janë: marrëveshja për financim dhe dokumenti i vlerësimit të projektit, plani vjetor i punës, i cili rrjedh nga plani për implementimin e projektit; udhëzimet e Bankës Botërore në lidhje me prokurimet e financuara përmes huave. Kodi i sjelljes dhe kodi i

etikës ka për qëllim të jetë si: Udhëzues për përfaqësuesit e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, Komisionit të projektit PATEL dhe Zyrës së projektit (ZP) të cilët marrin pjesë në procesin e biznesit i cili ka si element aktivitetin e prokurimit, në çfarëdo faze dhe çfarëdo niveli të inputeve, drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë. Për punën e KDP rreth projektit Kosova-C informacione shtese mund te merren nga Zyra e Projektit, Asistenca Teknike Energjia nga Linjiti (www.lpi-ks.com).

MBROTJA E KONSUMATORËVE

4.1 BAZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Sipas nenit 15.2 g) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji ka kompetenca të zgjidhë kontestet në mes të konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve. Në bazë të nenit 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji mund të hartojë procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë përfshirë ankesat:

- a) nga konsumatorët kundër të licencuarve që kanë të bëjnë me shërbimet e ofruara;
- b) nga i licencuari kundër të licencuarve të tjerë, që ka të bëjë me performancën e aktiviteteve të licencuara;
- c) që kanë të bëjnë me qasjen e palës së tretë dhe bartjes, shpërndarjes së energjisë elektrike apo rrjetit të gazit natyral si dhe bartjes ndërkufitare të energjisë elektrike dhe gazit natyral.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në pajtim me autoritetin e dhënë me nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin për Energji në seancën e mbajtur më 17 janar 2006 ka miratuar Rregullin mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Rregulla mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë definojnë obligimet: e të licencuarve, të ZRRE-së dhe të konsumatorëve se si duhet aplikuar, pranuar, regjistruar, proceduar dhe zgjidhur ankesat e konsumatorëve. Secila ndërmarrje e licencuar është e obliguar që në pajtim me këtë Rregull të përgatisë procedurat e brendshme për zgjidhjen e kontesteve me konsumatorë. Rregulla mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë përcakton termat, kushtet dhe procedurat në lidhje me zgjidhjen e kontesteve në mënyrë që:

- a) të sigurojë aftësinë e kryerjes transparente dhe jo diskriminuese të aktiviteteve për energjinë në Kosovë;
- b) të mbrojë konsumatorët përmes promovimit të qasjes transparente dhe të hapur ndaj informacioneve që kanë të bëjnë me zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve dhe zgjidhjen e kontesteve;
- c) zgjidhë kontestet në mes të konsumatorëve dhe furnizuesve, si dhe në mes të ndërmarrjeve të energjisë;
- d) të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues ndaj të gjithë konsumatorëve në Kosovë, me respekt ndaj të drejtave dhe detyrimeve të tyre në lidhje me shërbimet e energjisë.

DMK është përgjegjës për sigurimin e aplikimit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë. Kryesuesi i DMK-së, ka mandatin që të lëshojë **Vendim** për ankesat që vijnë nga konsumatorët shtëpiak dhe të përgatisë **Rekomandim** për Bordin e ZRRE-së për ankesat e konsumatorëve tjerë (komercial, institucione, industrisë etj). Ky departament është kompletuar me staf në mars të vitit 2005, me mandat dhe detyra që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve.

4.2 ANKESAT DHE AKTIVITETET NË ZGJIDHJEN E KONTESTEVE

Duke u bazuar në dispozitat e Rregullës për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, gjatë këtij viti DMK regjistruar 115 ankesa të konsumatorëve në regjistrin e ankesav. Në Tab.4.1 janë paraqitë ankesat sipas arritjes kohore në ZRRE dhe natyrës së tyre.

Tab. 4.1. Numri i ankesave të regjistruar nga DMK gjatë vitit 2007

	Shfrytëzimi i paautorizuar	PEP (Taksa për RTK)	Faturimi pa matje paushall	Gjobat për shkyçje	Transfer borxhi	Lexim i pasakt	Raste sociale	Të tjera	Gjithsejt
Janar	1	1	1	0	1	1	0	1	6
Shkurt	0	0	1	4	0	0	0	1	6
Mars	1	1	1	2	0	0	0	2	7
Prill	3	0	0	0	0	0	0	3	6
Maj	3	2	1	1	0	1	0	5	13
Qershor	4	1	2	1	3	0	0	2	13
Korrik	5	4	3	0	3	0	4	1	20
Gusht	1	0	1	0	0	0	0	4	6
Shtator	0	3	0	2	2	0	2	1	10
Tetor	0	3	0	2	1	0	0	1	7
Nëntor	3	1	1	1	3	2	0	0	11
Dhjetor	2	1	0	1	0	1	0	5	10
Gjithsejt	23	17	11	14	13	5	6	26	115

Ankesat e regjistruara në Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) janë të llojeve të ndryshme: shfrytëzim i pa-autorizuar, faturimi pa matje ("afofe"), parapagimi për RTK, gjobat për shkyçje, bartje borxhi, lexim/faturim i pasaktë, rastet sociale etj.

Nga Tab. 4.1 e ankesave të regjistruara në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, shihet se numri më e madh i ankesave të konsumatorëve ka qenë shfrytëzimi i pa-autorizuar, ku pjesëmarrja e tyre në ankesat e përgjithshme ka qenë rreth 20 %.

Shfrytëzimi i pa-autorizuar është i lidhur drejtpërdrejt me humbjet komerciale të energjisë elektrike. Duhet të theksohet se me rastin e analizimit të këtyre ankesave janë vërejtur shumë mangësi në proceset e përgatitura nga ana e KEK-ut, andaj numri i ankesave të zgjidhura deri më tani për këtë lloj të ankesave është i vogël (6). ZRRE-ja ka kërkuar dëshmi të qëndrueshme nga ana e KEK-ut për të argumentuar shfrytëzimin e pa-autorizuar të energjisë.

Vendimet e DMK-së dhe të Bordit të ZRRE-së do të bazohen në faktet e paraqitura nga palët. DMK kërkon që KEK-u të ofroi të gjitha dëshmitë e këtyre rasteve dhe zbatimin e përpiktë të kornizës ligjore dhe rregullative në fuqi, në mënyrë që të ndalojë dhe dënojë konsumatorët që bëjnë shfrytëzim të pa-autorizuar të energjisë.

Pagesa e taksës së emetuesit publik (taksa e RTK) ka paraqitur një pakënaqësi të madhe tek konsumatorët, kjo taksë është e futur në faturën e energjisë elektrike sipas Ligjit Nr. 02/L-47, për Radiotelevizionin e Kosovës, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Kjo taksë është përfshirë në faturat për energji elektrike në bazë të një kontrate ndërmjet të RTK-së dhe KEK-ut. Shumë konsumatorë e kundërshtojnë pagesën e faturave të energjisë elektrike për arsye të taksës për RTK. DMK u ka shpjeguar konsumatorëve se një veprim i tillë i KEK –ut është në pajtim me Ligjin, por ka theksuar se brenga e tyre do ta paraqitet tek ligjvënësi. DMK si zbatues i kornizës ligjore dhe rregullative ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr. 02/L-47 andaj të gjitha ankesat e kësaj natyre janë refuzuar.

KEK-u në vitin 2007 ka ndërmarrë aksion për rishikim e konsumatorëve pasivë, si rezultat i këtij aksioni ka qenë bartja e borxheve të disa pikave matëse pasive tek konsumatorët aktivë, që tani janë shfrytëzues të objekteve apo lokacioneve ku kanë qenë të vendosura këto pika matëse pasive.

Shumë konsumatorë e kanë kontestuar këtë veprim të KEK-ut duke argumentuar se borxhet janë të pronarëve paraprakë dhe kundërshtojnë pagesën e kësaj ngarkese. DMK ka analizuar secilin rast dhe ka kërkuar dëshmi shtesë nga të dyja palët për të kompletuar lëndët, në mënyrë që vendimet e DMK të jenë në pajtim me ligjin.




Fig. 4.1. Paraqitja grafike e ankesave të regjistruara nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE

Nga 115 ankesa të regjistruara në DMK kemi:

- 86 ankesa të konsumatorëve shtëpiakë;
- 28 ankesa të konsumatorëve komercialë;
- 1 ankesë e konsumatorit industrial.

4.2.1 ZGJIDHJA E ANKESAVE TË KONSUMATORËVE

DMK-ja, ankesat e konsumatorëve i klasifikon varësisht sipas kategorisë në: konsumatorë shtëpiakë, konsumatorë komercialë dhe konsumatorë industrialë. Në bazë të nenit 14.1 të Rregullës për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, DMK pas pranimit të ankesës, regjistron ankesën, analizon, kërkon kompletim të dokumentacionit, bënë vizita në teren, kërkon nga palët që të shfrytëzojnë mundësinë e zgjidhjes së kontestit përmes zgjidhjes alternative të kontestit (negocim, meditim) dhe përfundimisht nxjerr një vendim ose rekomandim, në përputhje me Nenin 14.3 dhe 14.5 mbi referimet e ankesave.

Tabela 4.2. Numri i ankesave të zgjidhura nga DMK në ZRRE gjatë vitit 2007

	Shfrytëzi mi i paaautoriz uar	PEP (Taksa për RTK)	Faturimi pa matje paushall	Gjobat për shkycje	Transfer borxhi	Lexim i pasakt	Raste sociale	Të tjera	Gjithsejt
Janar	0	0	0	0	0	0	0	5	5
Shkurt	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	1	1	0	1	0	0	0	0	3
Prill	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	0	1	0	1	0	0	0	2	4
Qershor	0	2	1	4	0	0	0	1	8
Korrik	0	0	1	1	0	0	0	1	3
Gusht	0	3	3	1	0	0	3	0	10
Shtator	0	1	0	1	2	0	1	6	11
Tetor	1	2	1	1	4	0	1	6	16
Nëntor	1	3	0	1	1	0	0	0	6
Dhjetor	3	3	0	4	2	0	0	0	12
Gjithsejt	6	16	6	15	9	0	5	21	78

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE gjatë vitit 2007 ka arritur t'i procedoj dhe t'i zgjidh 78 ankesa të konsumatorëve të natyrave të ndryshme dhe kategorive të ndryshme të konsumatorëve. Për 75 ankesat e zgjidhura gjatë vitit 2007 DMK, ka lëshuar:

- **41 Vendim** për konsumatorët shtëpiakë,
- **15 Rekomandime** për Bordin e ZRRE-së (13 për konsumatorët komercialë, 2 për konsumatorët e industrisë), pas së cilave Bordi ka nxjerrë **"Vendime"**,
- **19 Përgjigje/Njoftime** për ankesat të cilat kanë të bëjnë me kontestet para vitit 2004. Këto përgjigje/njoftime janë bazuar në nenin 32.1 të Rregullës për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, e cila thotë: "se për kontestet e konsumatorëve para vitit 2004, pavarësisht nga natyra e

kontestit, Zyra e Rregullatorit për Energji nuk ka kompetenca në zgjidhjen e tyre por vetëm gjykata kompetente”.

- **3 Ankesa** të konsumatorëve janë tërhequr nga DMK në ZRRE pasi që konsumatorët kanë arritur marrëveshje me KEK SH.A

Në Tab. 4.2 është paraqitur numri i ankesave të zgjidhura sipas muajve dhe llojit të ankesës. Në shtyllën ku janë paraqitur ankesa të tjera, janë ankesat e konsumatorëve për: mbingarkesë, kërkesa për falje të borxhit, ndërrim njehsori, kërkesa për të bërë njehsorin pasivë etj.




Fig. 4.2. Paraqitja grafike e ankesave të zgjidhura nga DMK

Duhet theksuar se në fillim të vitit 2007, janë të bartura 22 ankesa të pazgjidhura nga viti 2006. DMK ka arritur t'i zgjidhë në vitin 2007 15 nga këto ankesa.

Tab. 4.3. Krahasoni i ankesave të regjistruar me ato të zgjidhura nga DMK e ZRRE (viti 2007)

	Regjistruara	Zgjidhura	Të pazgjidhura në fund të muajit
Dhjetor 2006			22
Janar	6	5	23
Shkurt	6	0	29
Mars	7	3	33
Prill	6	0	39
Maj	13	4	48
Qershor	13	8	53
Korrik	20	3	70
Gusht	6	10	66
Shtator	10	9	67
Tetor	7	15	59
Nëntor	11	6	64
Dhjetor	10	12	62
Gjithsejtë	115	75	62

Ankesat e pazgjidhura (62) janë edhe më tutje në proces të kompletimit të dokumentacionit dhe fakteve relevante për zgjidhjen e tyre, ndërsa 15 ankesa është

nisur procedura e zgjidhjes përmes marrëveshjes në mes të KEK-ut dhe konsumatorit, andaj presim arrijtjen e marrëveshjes për ti përfunduar këto raste.




Fig. 4.3. Paraqitja grafike e krahasimit të ankesave të regjistruara dhe atyre të zgjidhura nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE gjatë viti 2007

4.2.3 AKTIVITETE TË TJERA TË DMK

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve, gjatë vitit 2007 ka pasur një ndihmesë nga asistencë teknike e konsulencës ndërkombëtare për ZRRE, të financuar nga AER. Si rezultat i kësaj, ka qenë përgatitja e pesë raporteve, si vijon:

- Raporti i vetëdijesimit të konsumatorëve;
- Raporti i përfaqësimit të konsumatorëve;
- Raporti i zgjidhjes së kontesteve;
- Raporti i kualitetit të shërbimeve;
- Raporti i përmbushjes së kërkesave të konsumatorëve;

Përfaqësuesi i DMK të ZRRE-s, gjatë vitit 2007 ka qenë anëtar në një grup punues lidhur me “Fushatën e Vetëdijesimit Publik” për përmirësimin e arkëtimit dhe efijencës së energjisë, të financuar nga AER, dhe implementuar nga një kompani vendore. Në këtë grup punues, përveç përfaqësuesit të ZRRE-së kanë qenë të angazhuar edhe përfaqësuesit e KEK SH.A, Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, dhe Agjencioni Evropian për Rindërtim. Fushata e vetëdijesimit publik për përmirësimin e arkëtimit dhe efijencë të energjisë ka filluar me datë 15 Mars 2007 dhe ka përfunduar me datë 15 Gusht 2007. Gjatë kësaj fushate ka pasur reklama televizive, broshura të ndryshme, pllakate të vendosur nëpër vende të ndryshme në Kosovë, radio reklama, intervista nëpër radio e shumë aktivitete të ndryshme.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka pasur takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e KEK SH.A. Në këto takime janë diskutuar çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve si dhe veprimet e KEK-ut për përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE VENDORE DHE ATO NDËRKOMBËTARE

Kosova s'q dihet ka nënshkruar dhe ratifikuar Marrëveshjen e Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore (TKEEJL / ECTSEE-Energy Community Treaty of South East Europe) në vitin 2005, dhe me këtë Kosova ka pranuar obligime në krijimin e treguat nacional të energjisë si dhe ndërtimin e tregut rajonal të energjisë. Detyra e ZRRE-së në këtë proces është të udhëheq dhe koordinojë rregullimin në sektorin e energjisë elektrike, në sektorin e gazit natyror dhe ngrohjes qendrore me proceset rregullative rajonale.

5.1 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE DHE ORGANIZATA VENDORE SI DHE PJESËEMARRJA NË KOMISIONE TË NDRYSHME

ZRRE-ja gjatë vitit 2007, në bazë të përgjegjësisë dhe detyrave të parapara me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë të Kosovës, nr. 2004/9, ka pasur një varg takimesh pune me institucionet e autorizuar shtetërore dhe institucione dhe organizma të tjera vendore dhe të jashtme, e që veprojnë në Kosovë, si: Qeveri, Parlament, Komisionet Parlamentare, Ministri, Ndërmarrje Energjetike: KEK, KOST, "Ibër-Lepenc", "HC Lumëbardhi"; Komitetin drejtues të projektit "Kosova – C"; donatorë si: USAID, Banka Botërore, Banka Gjermane KFW, AER, etj. Në këto takime kryesisht janë diskutuar çështje të cilat janë brenda fushës së përgjegjësisë dhe obligimeve ligjore të ZRRE-së si në lëmin e tarifave, problematikën e ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike, burimet e ri përtrishme, mbrojtja e konsumatorëve, mbështetja e mëtutjeshme institucionale e ZRRE-së, etj.

Nga fundi i vitit 2007, ZRRE-ja ka asistuar MEM-in, për azhurnimin e "Hartës Rrugore" ("Road Map-in") të dërguar nga Sekretariati i TKEEJL me shënime të reja dhe plane të aktiviteteve konkrete për çdo institucion kosovarë për vitin 2008. Sekretariati është i vendosur në Vjenë, dhe të gjitha aktivitetet dhe raportet gjatë vitit 2007 mund të gjinden në ueb faqen: www.seenergy.org.

Përfaqësuesit e ZRRE-së kanë qenë edhe pjesë e grupit pranë MEM, për integritet evroplane.

5.2 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE PJESËEMARRJA NË TAKIME TË ORGANIZUARA NË KUADËR TË TRAKTATIT TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË TË EUROPËS JUGLINDORE

ZRRE-ja gjatë vitit 2007 ka qenë pjesëmarrëse aktive në organet e Traktatit të Komunitetit Energjisë së Evropës Jug-lindore, në radhë të parë organeve rregullative.

Organi rregullativ i TKEEJL është Bordi Rregullativ (Energy Community Regulatory Board – ECRB), i formuar nga përfaqësuesit e rregullatorëve nacionalë, përfaqësuesit të komisionit evropian, dhe asistencës së një përfaqësuesi të një rregullatori të Unionit Europian (UE) dhe një përfaqësuesi nga Grupi i Rregullatorëve të UE për Energji Elektrike dhe gaz (ERGEG).

■ **Bordi rregullativ i TKEEJL**

Bordit Rregullativ i TKEEJL (BR i TKEEJL) vepron në Athinë. Sipas Planit të Punës, në 2007 detyrat e BR të TKEEJL kanë qenë këto: roli këshillëdhënës për Këshillin Ministror të TKEJL-it në çështje të monitorimit dhe qasjes së punës të sistemit elektro energjetik dhe tregut rajonal me sugjerime për funksionim të rregullt të tregut rajonal, evidentimi i legjislacionit dhe veprimeve që nuk përputhen me TKEEJL, nxitja e bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve për zbatim të “*acquis communautaire*” në çështje të energjisë, kontestet ndërkufitare ndërmjet transmiseve nacionale, puna drejt një tregu të përbashkët të energjisë elektrike dhe gazit, hapja e mëtutjeshme e tregut, njohja reciproke e licencave në rajon, marrje qëndrimi në lidhje me balancimin rajonal, krijimi zyres për aukcion për rajonin e Europës Jug-lindore, ndërsa në sektor të gazit është kryer raporti “Rregullativa për Investimet në Infrastrukturën e Re të Gazit, Komuniteti i Energjisë së EJL 2006-2007”.

Zyra e Rregullatorit për Energji gjatë vitit 2007, ka marrë pjesë në grupe dhe komisione të ndryshme të krijuara brenda TKEEJL si: **grupi punues për energji elektrike, grupi punues për gaz**, etj. Gjithashtu përfaqësuesit e ZRRE-e kanë marrë pjesë në komisione, tryeza të punës, dhe trajnime të organizuara nga ERRA (Energy Regulators Regional Association), si në grupin për çështje legale dhe rregullative, komisionin për licenca dhe konkurrencë, tarifa, etj.

■ **Asociacioni i rregullatorëve rajonal për energji** (Energy Regulators Regional Association -ERRA)

Kjo organizatë është e formuar nga rregullatorët e pavarur energjetikë nacionalë të Evropës Qendrore, Lindore dhe numrit më të madh të shteteve ballkanike. Ky asociacion ka gjithsej 22 anëtarë të rregullt dhe 4 të asocuar. Kosova, për shkak të statusit politik të pazgjidhur, është anëtare e asocuar. Asociacioni i Rregullatorëve Nacional të SH.B.A. (National Association of Regulatory Utility Commissioners, USA) gjithashtu është anëtar i bashkangjitur i këtij asociacioni. Asociacioni ka katër grupe punuese: atë të licencimit, të tarifave, të rregullimit ligjor dhe integriteteve europiane. ZRRE-ja përfaqësohet në të gjitha këto grupe punuese të këtij asociacioni. Me iniciativë të ERRA-s është formuar matricë me të dhënat e rregullatorëve rajonalë, ZRRE-ja ka bashkëpunuar aktivisht me ERRA-n në këtë aktivitet.